



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 311 Akti

Nr. 367 Vendimi
Tiranë, më 16.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 9.4.2021, ora 10:00 në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bledar Maksuti**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Bledar P. Maksuti, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga data 1.8.2008 e në vijim është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Olsi Komici dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Anëtari i trupit gjykues Olsi Komici paraqiti menjëherë dorëheqjen për shkak të konfliktit të interesit me subjektin. Me vendimin nr. 2, datë 22.11.2019, të trupit gjykues të ngritur me short¹, u pranua kërkesa për dorëheqje e komisionerit. Anëtari Olsi Komici u zëvendësua me komisionerin Lulzim Hamitaj, i zgjedhur si komisioner zëvendësues me shortin e datës 12.11.2019.

5. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 25.11.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Maksuti.

6. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse

¹ Vendim nr. 75, datë 20.11.2019, i Komisionit.

subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Maksuti. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017³.

13. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 9.3.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Maksuti; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve

² Shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2018

³ Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 24.6.2020, të KDZH-së.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020

të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 10.3.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

17. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 23.3.2021.

18. Në datën 23.3.2021, ora 10:27, me anë të *e-mail-it*, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Komisionit me kërkesë për shtyrjen e afatit të dorëzimit të provave dhe shpjegimeve. Kjo kërkesë u pranua nga trupi gjykues, duke e zgjatur këtë afat edhe me një javë.

19. Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 2.4.2021.

20. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁵.

II. SEANCA DËGJIMORE

21. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 6.4.2021.

21.1. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit filloi në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.4.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Z. Bledar Maksuti ka qenë plotësisht bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ dhe iu është përgjigjur në kohë pyetjeve të Komisionit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

24. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁵ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 6.4.2021

⁶ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit dhe nëpërmjet postës elektronike.

A. VLERËSIMI I PASURISË

26. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

27. Subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, ka punuar për periudhën:

- gusht 2008 – prill 2012 si prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
- prill 2012 e në vijim si prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si vijojnë:

28. Shtëpi banimi⁷, apartament me sip. 133.4 m², të ndodhur në rr. “D. B”, p. N, shk. *, k. *, ap. **, Njësia nr. **, Tiranë, blerë në vitin 2004. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese nuk deklarohet.

28.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e përbashkëta familjare, kryesisht të babait si noter dhe avokat, si dhe nga shitja e dy apartamenteve të tjera në Peshkopi dhe Tiranë.

28.2. Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *fshehje e kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2004, në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004, për blerje apartamenti me sip. 133.4 m², në rr. “D. B”, Tiranë, në vlerën totale prej 5.221.580 lekësh;*
- *deklarim i rremë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit me sip. 133.4 m², në rr. “D. B” Tiranë, deklaruar nga subjekti në shumën 60.000 euro, referuar kontratës vlera është*

i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë⁷. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁷ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.5.2016; (ii) kontratë sipërmarrjeje nr. **** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2004; (iii) kontratë shitjeje e vitit 2010; (iv) vërtetim hipotekor nr. ***, datë 29.6.2010; (v) kontratë shitblerjeje nr. *** regj., datë 4.6.1993; (vi) aktmarrëveshje datë 10.6.2004, për shitblerje apartamenti; (vii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2005.

5.221.580 lekë. Dyshime se vlera më e ulët në kontratën e shitjes është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore ndaj shtetit;

- rezulton se për apartamentin e përfutur nga privatizimi në Dibër subjekti ka paraqitur “aktmarrëveshjen datë 10.6.2004, për shitje apartamenti me vlerë 2.500.000 lekë”, kurse nga ZVRPP-ja Dibër konfirmohet shitja me kontratën nr. **** rep., nr. *** kol., datë 5.7.2005, në vlerën 1.000.000 lekë. Dyshime se vlera më e ulët në kontratën e shitjes është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore ndaj shtetit;
- pasaktësi në lidhje me vlerën e apartamentit me sip. 79 m², në rr. “D. B”, Tiranë, pasi në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës së vitit 2004 është deklaruar në vlerën 3.500.000 lekë; në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004 është deklaruar në vlerën 23.000 USD. Referuar kontratave të shitblerjeve konkretisht; kontratës së blerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2000, vlera është 19.000 USD, kurse në kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. ** kol., datë 24.6.2005, vlera është 1.900.000 lekë.

Hetimi⁸/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

29. Në datën 13.12.2004 subjekti ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me nr. ***** për porositjen e një apartamenti me sip. 151 m², në rrugën “D. B”, Tiranë, me vlerë 34.580 lekë/m² ose në total 5.221.580 lekë. Bazuar në këtë kontratë pagesa do të bëhej me këste, ku 40 % e vlerës do të likuidohej në momentin e lidhjes së kontratës, 50 % në momentin kur të përfundohej objekti si karabina dhe 10 % në momentin kur të përfundohen të gjithë punimet.

29.1. Duke qenë se në deklaratën “Vetting” subjekti e ka deklaruar këtë apartament në vlerën 60.000 euro, ka rezultuar mospërputhje midis kësaj deklarate dhe kontratës së sipërmarrjes, të depozituar nga subjekti. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigjet e pyetësorit datë 1.6.2020, subjekti sqaron se apartamentin e ka blerë karabina dhe nga ana e familjes së tij janë kryer të gjitha punimet e tjera për ta bërë apartamentin të banueshëm. Shuma totale, së bashku me mobilimin, është 23.000 euro dhe kjo ka qenë arsyeja që subjekti ka deklaruar vlerën 60.000 euro në deklaratën “Vetting”.

29.2. Për sa i përket pagesës, subjekti ka deklaruar se shuma 2.500.000 lekë është paguar nëpërmjet sistemit bankar, ndërsa shuma tjetër prej 2.721.580 lekësh i është dhënë dorazi administratorit të shoqërisë, z. Xh. N.

29.3. Pagesa e kështit të parë vërtetohet me urdhërderdhjen datë 1.12.2004, në “R.B”, nëpërmjet së cilës subjekti i ka paguar shoqërisë “N” sh.p.k. shumën 2.500.000 lekë. Në lidhje me kështin e dytë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 9.12.2020, ka sqaruar se është paguar në qershor të vitit 2005, duke vënë në dispozicion vërtetimin datë 14.12.2020, të shoqërisë “N” sh.p.k.

29.4. Kontrata e shitjes⁹ për këtë apartament është lidhur nga babai i subjektit në vitin 2010 me vlerë 5.221.580 lekë, i cili ka paguar edhe taksën e shitjes në vlerën 133.400 lekë në datën 16.6.2010. Bazuar në shkresën e ASHK-së Tiranë rezulton se ky apartament është në pronësi të vetme të babait të subjektit të rivlerësimit, me nr. pasurie *****, z. k. ***.

29.5. Subjekti, gjatë hetimit administrativ në lidhje me pjesën e tij takuese në këtë apartament, në përgjigje të pyetësorit datë 9.12.2020, sqaroi se apartamenti është regjistruar në emër të babait të tij, duke deklaruar se pronësia është e këtij të fundit. Subjekti, edhe pas kalimit të

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.12.2019, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Dibër; shkresë kthim përgjigjeje e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri.

⁹ Kontrata nr. *****, datë 15.6.2010

barrës së provës në lidhje me këtë apartament, sqaroi se nuk ka asnjë të drejtë reale, pasi pronësia mbi këtë apartament është e babait të tij.

29.6. Si burim për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar: (i) shitjen e një apartamenti që familja e tij ka pasur në pronësi në Peshkopi; dhe (ii) shitjen e një apartamenti që familja e tij ka pasur në pronësi në Tiranë.

29.7. Babai i subjektit, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.6.1993, lidhur me EKB-në, ka blerë një apartament në Peshkopi për shumën 16.525 lekë.

29.8. Babai i subjektit, në datën 10.6.2004, ka lidhur me z. B.S aktmarrëveshjen për shitblerjen e apartamentit¹⁰ për shitjen e një apartamenti 2+1 në Peshkopi, për shumën 2.500.000 lekë. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje apartamenti do të lirohej deri më 30.6.2005, në datën e marrëveshjes do të jepej si kapar shuma 200.000 lekë, ndërkohë shuma tjetër do të paguhej kur të bëhej me akt noterial sipas Kodit Civil.

29.9. Nga dosja e pronës, e administruar nga Komisioni, ka rezultuar se ky apartament u është shitur nga subjekti dhe familjarët e tij në datën 5.7.2005, me kontratën nr. ****, për shumën 1.000.000 lekë shtetasve G dhe F. S. Pagesa e shumës 1.000.000 lekë vërtetohet me deklaratën noteriale¹¹ nr. ***, datë 9.9.2005, nënshkruar edhe nga subjekti i rivlerësimit.

30. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mospërputhjet e konstatuara në çmimin e shitjes së apartamentit, si dhe me blerësit e tij. Gjatë hetimit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 1.6.2020 dhe datë 9.12.2020, ka sqaruar se me shitjen këtij apartamenti, si dhe me përgatitjen e dokumentacionit të shitjes është marrë babai i tij. Sipas deklarimeve të babait apartamenti është shitur për shumën 2.500.000 lekë. Fillimisht është lidhur aktmarrëveshja për shitjen e apartamentit dhe shtetasi B. S ka paguar në datën 8.9.2005 shumën 2.300.000 lekë, të cilën babai i subjektit e ka depozituar në llogarinë bankare në BKT që kishte hapur në emër të bashkëshortes, znj. M.M. Pas shlyerjes së çmimit të blerjes u nënshkrua kontrata e shitblerjes. Në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes nga z. B. S subjekti ka pretenduar se nuk mund të japë shpjegime të tjera, pasi i ati ka ndërruar jetë në datën 8.8.2020. Subjekti ka deklaruar se nga sa ka dijeni, shtetasi B dhe G janë vëllezër dhe me sa kupton marrëveshjen e ka bërë shtetasi B. S për llogari të vëllait të tij, ndërsa blerjen e ka bërë shtetasi G.S.

30.1. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, pavarësisht faktit që me shitjen e kësaj pasurie mund të jetë marrë babai i tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare do të përfshihet vetëm shuma 1.000.000 lekë, e përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe në deklaratën noteriale. Gjithashtu, rezulton se edhe detyrimet tatimore janë paguar për shumën 1.000.000 lekë. Në përfundim të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, sipas së cilës: (i) subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” vlerën e shitjes së apartamentit; dhe (ii) në analizën financiare do të llogaritet vetëm shuma 1.000.000 lekë, pasi vetëm për këtë shumë janë paguar detyrimet tatimore.

30.2. Pas kalimit të barrës së provës subjekti deklaroi se përveç shpjegimeve të dhëna nga babai i tij përgjatë pyetësorëve nuk mund t'i përgjigjet më shumë faktit se pse ekziston kjo diferencë dhe ngjarjes se si ka ndodhur ky ndryshim. Megjithatë, vlera reale e shitjes së apartamentit ka qenë 2.500.000 lekë.

30.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Pavarësisht se me shitjen e kësaj pasurie është marrë babai i subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që subjekti ka pasur detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, pra, nuk ka qenë në detyrë, ky fakt

¹⁰ Apartamenti ka nr. pasurie *****, z. k. ****.

¹¹ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 28.7.2017, të ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së.

nuk e përjashton nga detyrimi për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së personit të lidhur, babait të tij.

30.4. Për rrjedhojë, Komisioni do të konsiderojë në analizën financiare si burim për blerjen e pasurisë apartament vetëm shumën 1.000.000 lekë.

30.5. Në datën 15.12.2000, subjekti, me anë të kontratës nr. ****¹², ka blerë një apartament¹³ në Tiranë, në shumën 19.000 USD.

30.6. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se në vitin 1998 është prenotuar një shtëpi në Tiranë në rr. “D.B”, kullat “H”, me sip. 79 m². Prenotimin e ka bërë në kohën që ka qenë student në Tiranë, duke qenë se babai, i cili ka kryer financimin e blerjes, ka qenë noter me seli në Peshkopi, Dibër dhe nuk mund të kryente veprimet në Tiranë. Apartamenti ka kushtuar 23.000 USD dhe është i regjistruar në emrin e tij dhe është shitur në vitin 2005 në vlerën e blerjes. Në kontratën e shitjes nr. **** kol., datë 24.6.2005, është pasqyruar vetëm kësti i fundit.

30.7. Duke qenë se kishte një mospërputhje midis çmimit të blerjes së apartamentit dhe çmimit të deklaruar nga subjekti, Komisioni i kërkoi sqarime subjektit, i cili sqaroi se vlera e pagesës është 19.000 USD për karabinanë dhe 4.000 USD janë paguar për punimet shitesë për apartamentin.

30.8. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit, ka kryer një analizë financiare për blerjen apartamentit, si vijon:

Tabela nr. 1

	Viti 1998	Viti 1999	Viti 2000
PASURI	2,671,020	0	3,884,810
Apartament 79 m ² , rr. “D. B”, kullat “H”	2,671,020.00	0.00	570,560.00
Dhënie hua motrës A. Ç, 25.000 euro			3,314,250.00
TË ARDHURA, dokumentuar	217,529.14	1,743,175.33	1,780,483.17
Të ardhura nga paga e subjektit	0.00	0.00	0.00
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	72,480.00	77,925.00	1,600,000.00
Pensioni i nënës	53,601.14	59,453.33	63,991.17
Pensioni i babait	0.00	0.00	0.00
Të ardhurat e motrës M. M.	91,448.00	105,797.00	116,492.00
Të ardhura nga shitja e pasurive	0.00	1,500,000.00	0.00
SHPENZIME	143,569	168,796	432,000
Shpenzime jetese	143,569	160,496	432,000
Udhëtime sipas sistemit TIMS	0	0	0
Shpenzime në Hipotekë	0	8,300	0
Mundësia për kursime	-2,597,060.09	1,574,379.61	-2,536,326.83

¹² Shihni shkresën nr. **** prot., datë 30.8.2017, të ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Nr. pasurie ***ND+****.

- Në analizën financiare, mbi vlerën e blerjes sipas kontratës 19.000 USD është shtuar vlera 4.000 USD, sipas deklarimeve të subjektit. Subjekti nuk ka deklaruar se kur është paguar kjo shumë¹⁴, kështu që është vendosur në vitin 2000 kur është nënshkruar kontrata.
- Gjithashtu është përfshirë edhe shuma 150.000 lekë për mobilimin e këtij apartamenti në vitin 2002¹⁵.

30.9. Nga analiza financiare rezulton se personi i lidhur me subjektin dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti në shumën 2.597.060,09 lekë në vitin 1998, si dhe për punimet shtesë të apartamentit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera në vitin 2000 në shumën 2.536.326,83 lekë.

31. Në datën 24.6.2005, subjekti, me anë të kontratës nr. ***¹⁶, ka shitur apartamentin me sip. 79 m², me nr. pasurie ***, z. k. ****, në shumën 1.900.000 lekë. Në nenin 3 të kontratës specifikohet se shitësi ofroi çmimin 1.900.000 lekë dhe blerësit pranuan ta lëvrojnë këtë shumë.

31.1. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se çmimi i shitjes për këtë apartament është 23.000 USD. Komisioni ka konsideruar në analizën financiare shumën 1.900.000 lekë, sipas kontratës, dhe jo shumën 23.000 USD të deklaruar nga subjekti.

31.2. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë apartament: (i) deklarimi i subjektit se në kontratën e shitjes së apartamentit është përfshirë kësti i fundit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar; (ii) subjekti nuk provoi se për shitjen e këtij apartamenti është paguar shuma 23.000 USD; (iii) në analizën financiare do të përfshihet shuma 1.900.000 lekë; (iv) personi i lidhur i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti në shumën 2.597.060,09 lekë në vitin 1998, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për punimet shtesë dhe shpenzimet e tjera në shumën 2.536.326,83 lekë në vitin 2000.

31.3. Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me të ardhurat e babait të tij për periudhën 1993 – 2000, subjekti vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacionin provues si vijon:

a. Dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore:

- i. shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, ku deklarohet se: *“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. s’ka, datë 16.3.2021, e protokolluar me nr. ****, datë 17.3.2021, ku kërkoni informacion për subjektin P.B.M (person fizik) me NIPT K****P, me objekt aktiviteti ‘shërbime juridike’, për periudhën 1992 – 2000, nga të dhënat në sistemin C@TS rezulton se nuk ka detyrime tatimore dhe gjithashtu nuk gjenden të dhëna të tjera, pasi dokumentacioni për periudhën në fjalë është dëmtuar”*;
- ii. fletënjoftim i tatimit datë 5.2.1998, për periudhën 1.1.1998 – 31.12.1998, shuma e tatimit: 56.000 lekë – tatimi fiks paguhej për xhiro deri në 2.000.000 lekë;
- iii. fletënjoftim i tatimit datë 26.1.1999 – tatimi fiks 40.000 lekë për xhiro deri në 2.000.000 lekë;
- iv. fletënjoftim i tatimit datë 30.1.2000 – tatimi fiks 60.000 lekë për xhiro deri në 2.000.000 lekë;
- v. deklaram për regjistrimin në sigurimin e detyrueshëm të datës 6.2.1998, me deklarues z. P. M;
- vi. mandatarkëtim datë 5.2.1998, pagesë taksë pastrimi 1.000 lekë;

¹⁴ Në pyetësorin nr. 1, datë 1.6.2020, në përgjigjen e pyetjes 3/c, subjekti sqaron se shuma 4.000 USD është paguar pas përfundimit të apartamentit.

¹⁵ Në pyetësorin nr. 1, datë 1.6.2020, në përgjigjen e pyetjes 3/e, subjekti deklaroi shumën 150.000 lekë për mobilim, pa përcaktuar vitin e shpenzimit. Shpenzimi është konsideruar si i kryer në vitin 2002, pasi në shtator të vitit 2002 subjekti është emëruar si OPGJ dhe ka jetuar aty.

¹⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. **** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së dhe shkresën nr. **** prot., datë 30.8.2017, të ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së.

- vii. vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore, datë 24.4.1999, ku vërtetohet shlyerja për vitin 1998 e këtyre detyrimeve nga z. P. M;
- viii. vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore, datë 21.1.2000, ku vërtetohet shlyerja për vitin 1999 e këtyre detyrimeve nga z. P.M;
- ix. deklaram për regjistrimin në sigurimin e detyrueshëm të datës 21.1.2000, me deklarames z. P. M.

b. Dokumentacion provues lidhur me kryerjen e aktivitetit tregtar nga babai i tij:

- i. certifikatë regjistrimi si noter për z. P. M për periudhën e veprimtarisë vjetore 1 janar – 31.12.1998, lëshuar nga dega e tatim-taksave Dibër;
- ii. certifikatë regjistrimi si noter për z. P. M për periudhën e veprimtarisë vjetore 1 janar – 31.12.2000, lëshuar nga dega e tatim-taksave Dibër;
- iii. vërtetim datë 30.3.1999, lëshuar nga Drejtoria e Punës Dibër, ku vërtetohet se z. P.M nuk merr pagesë papunësie;
- iv. certifikatë regjistrimi si noter për z. P.M për periudhën e veprimtarisë vjetore 1 janar – 31.12.1999, lëshuar nga dega e tatim-taksave Dibër;
- v. regjistrat noterialë të babait për periudhën 1996 – 1999;
- vi. shkresë nr. B-**** prot., datë 29.3.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, ku është vënë në dispozicion:
 - a. shkresë me miratim tarifash për kryerjen e shërbimeve noteriale nr. **** prot., datë 11.8.1994, sipas së cilës tarifat variojnë nga 100 lekë – 1.000 lekë;
 - b. shkresë nr. **** prot., datë 9.9.1994, ku përcaktohet se noterizimi i akteve noteriale për privatizimin e banesave shtetërore është 100 lekë;
- vii. shkresë nr. *** prot., datë 22.3.2021, e Dhomës Kombëtare të Noterisë, sipas së cilës nuk disponon informacion për periudhën 1994 – 2000 për tarifat noteriale;
- viii. shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2021, e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, sipas së cilës nuk disponojnë dokumentacion për periudhën 1992 – 1996, pasi aktiviteti i avokatisë ka qenë tërësisht i varur dhe i drejtuar nga Ministria e Drejtësisë;
- ix. aktet juridike (padi, ankime etj.) të përpiluara nga babai i tij në cilësinë e avokatit për periudhën 1992 – 1996;
- x. një dokument me emërtim “partitari i llogarisë” për të cilin subjekti pretendon se është regjistri i avokatit i babait P. M.

31.4. Gjithashtu, subjekti, në lidhje me të ardhurat e babait për periudhën 1993 – 2000, ka pretenduar se për sa kohë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër konfirmohet fakti se i ati nuk rezulton debitor në sistemin e tatimeve, do të thotë se janë paguar tatimet. Ndërkohë, konfirmimi zyrtar i faktit se dokumentacioni për periudhën 1992 – 2000 është dëmtuar, e bën subjektin të ndodhet përpara situatës të parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pra, se ai ndodhet në kushtet e pamundësisë për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

31.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson të marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 2000, pasi subjekti:

- a. ka arritur të provojë që babai i tij ka paguar detyrimet tatimore për periudhën 1998 – 2000 dhe, për rrjedhojë, të ardhurat duhet të merren në konsideratë. Komisioni i është referuar tatimit të paguar nga babai i subjektit për të nxjerrë xhiron dhe më pas fitimin;
- b. subjekti ka vënë në dispozicion regjistrat e noterit të babait për periudhën 1996 – 1997, ku rezultojnë shumat e paguara për çdo shërbim noterial.

31.6. Në vlerësim të Komisionit regjistri i noterit përbën provë shkresore, në kuptim të neneve 246¹⁷ dhe 260¹⁸ të Kodit të Procedurës Civile.

31.7. Për sa më sipër, subjekti ka arritur të provojë të ardhurat e babai të tij nga aktiviteti i noterisë për periudhën 1996 – 1997.

31.8. Për sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore për periudhën 1996 – 1997, Komisioni prezumon që ato janë paguar, për sa kohë Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër deklaron se z. P. M nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe se dokumentacioni për periudhën 1993 – 2000 është i dëmtuar. Gjithashtu, Komisioni u referohet edhe të dhënave në regjistrat noterialë, të cilat rezultojnë të jenë certifikuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

31.9. Komisioni, për të nxjerrë të ardhurat e babait të subjektit për periudhën 1996 – 1997, ka mbledhur shumat në regjistrat noteriale, duke nxjerrë të ardhurat vjetore dhe fitimin vjetor të tij.

32. Në përfundim, Komisioni, për periudhën 1996 – 1999, i njeh këto të ardhura subjektit, si vijon:

Tabela nr. 2

Viti	Shuma në lekë
1999	1,280,000
1998	1,120,000
1997	664,054
1996	1,140,580

32.1. Në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit për periudhën 1993 – 1995 është bërë një llogaritje bazuar në regjistrin e avokatit të tij, mbajtur me shkrim dore, nga i cili janë nxjerrë çështjet vjetore të të atit, ndërsa çmimi për çështje është marrë 500 lekë, referuar akteve të mëposhtme:

- aktmarrëveshje datë 10.8.1994 “...ndërmjet Ndërmarrjes së Grumbullimit të Drithit Peshkopi dhe avokatit të rrethit Dibër, z. P. M...”;
- aktmarrëveshje datë 21.12.1994 “...ndërmjet drejtorisë së NTPN Dibër dhe avokatit të rrethit Dibër, z. P. M...”.

Tabela nr. 3

¹⁷ Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, shtesa midis rreshtave ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.

¹⁸ Shkresa private quhen edhe: librat e tregtarëve dhe profesionistëve që i mbajnë sipas Kodit Tregtar ose dispozitave të tjera; dhe librat e avokatëve, noterëve, përmbauesve, mjekëve, farmacistëve e profesioneve të tjera, sipas dispozitave në fuqi.

Kur paraqiten si provë pjesë nga libri ose e tëra dhe përmbajnë edhe të dhëna që nuk kanë lidhje me objektin e gjykimit, mund të merren ato pjesë të shkresës që kanë lidhje me të.

Vitet	Nr. i akteve sipas regjistrit	Çmimi për akt	Pagesa mesatare si avokat	Qarkullimi në lekë
1992	52.00	500.00	500.00	52,000.00
1993	615.00	500.00	500.00	615,000.00
1994	557.00	500.00	500.00	557,000.00
1995	557.00	500.00	500.00	557,000.00
Totali	1,781.00	2,000.00	2,000.00	1,781,000.00

32.2. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, Komisioni prezumon që ato janë paguar, për sa kohë subjekti ka depozituar një numër të konsiderueshëm aktesh juridike (padi, ankime etj.) të përpiluara nga babai i tij, në cilësinë e avokatit, për periudhën 1992 – 1996.

32.3. Subjekti ka dorëzuar së bashku me deklaratën “Vetting” edhe:

- licencën nr. ***, datë 27.8.1992, lëshuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë në datën 2.9.1992, nëpërmjet së cilës babait të subjektit i jepet e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit me qendër në Peshkopi;
- vendimin nr. ***, datë 3.9.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për regjistrimin si person juridik privat të babait të subjektit në fushën e avokatisë.

32.4. DRT-ja Dibër ka informuar se z. P. M nuk ka detyrime të papaguara për periudhën 1992 – 2000 dhe se dokumentacionin për këtë periudhë është i dëmtuar.

32.5. Duke qenë se për vitin 1995 nuk kemi të dhëna nga regjistri i avokatit, por ndërkohë subjekti ka sjellë një numër të konsiderueshëm aktesh juridike, të ardhurat për vitin 1995 janë marrë në të njëjtën vlerë me vitin 1994.

32.6. Në përfundim, Komisioni i njeh këto të ardhura të subjektit për periudhën 1992 – 1997, sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 4

Viti	Shuma në lekë
1995	389,900.00
1994	389,900.00
1993	430,500.00
1992	36,400.00

32.7. Duke marrë në konsideratë të ardhurat e mësipërme rezulton se babai i subjektit ka një bilanc negativ për apartamentin e blerë në vitin 1998, si vijon:

- në vitin 1998 nuk kanë pasur mundësitë për kursime kumulative në shumën 491.657,10 lekë;
- në vitin 1999 kanë pasur mundësi për kursime kumulative në shumën 1.879.293,23 lekë;
- në vitin 2000 nuk kanë pasur mundësi për kursime kumulative në shumën 657.033,60 lekë.

32.8. Në lidhje me bilancin negativ për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni vlerëson se ai nuk përbën shkak të mjaftueshëm për shkarkim, duke marrë në konsideratë faktin se:

- i. të ardhurat e babait mund të kenë qenë më të larta se sa i janë llogaritur;
- ii. shpenzimet familjare të subjektit, duke qenë se familja e tij jeton në Dibër, mund të kenë qenë më të ulta se sa janë llogaritur;
- iii. subjekti ka qenë student në momentin e blerjes së këtij apartamenti.

32.9. Komisioni vlerëson të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit se vlera reale e shitjes së apartamentit është 23.000 USD, pasi ato nuk janë bindëse, për rrjedhojë, në analizën financiare do të përfshijë shumën 1.900.000 lekë, të përshkruara në kontratën përkatëse.

33. Komisioni ka kryer një analizë financiare për blerjen e apartamentit në pronësi të babait të subjekti në rrugën “D. B”, rezultati i së cilës pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5

	Viti 2004	Viti 2005
PASURI	2,500,000	5,569,348
Apartament me sip. 133.4 m ² , rr. “D. B”, Tiranë	2,500,000.00	2,721,580.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	0.00	2,847,767.57
Likuiditete gjendje	0.00	2,847,767.57
TË ARDHURA, dokumentuar	1,724,526.64	4,847,539.98
Të ardhura nga paga e subjektit	577,895.00	753,717.00
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	950,000.00	997,400.00
Pensioni i nënës	90,987.82	98,211.49
Pensioni i babait	105,643.82	98,211.49
Të ardhura nga shitja e pasurive	0.00	1,900,000.00
Të ardhura nga shitja e pasurive	0.00	1,000,000.00
SHPENZIME	549,730	2,516,118
Shpenzime jetese	328,671.00	328,671.00
Udhëtime sipas sistemit <i>TIMS</i>	216,058.50	47,426.71
Shpenzime në Hipotekë	0.00	6,800.00
Investime/mobilim për ap., pyetësori datë 1.6.2020	0.00	2,133,220.00
Shpenzime të tjera	5,000.00	0.00
Mundësia për kursime	-1,325,202.86	-3,237,925.30

33.1. Në përfundim, subjektit iu kaluar barra e provës për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -4.563.128 lekë për blerjen e kësaj pasurie.

33.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi, duke kërkuar që: (i) të përfshiheshin të ardhurat e babait të tij për periudhën 1992 – 2000, të trajtuara në pikat 27.2.2.5 dhe 27.2.2.6 të këtij vendimi; si dhe (ii) të përfshiheshin të ardhurat nga puna e tij pranë ECMM (*European Community Monitor Mission*) dhe nga angazhimi i tij me zyrën e IRC në Peshkopi (*International Rescue Committee*). Subjekti pretendoi se për shkak të kohës së largët që ka kaluar, mbylljes së këtyre misionëve dhe largimit të personave që kanë qenë të punësuar në atë periudhë, gjendet në pamundësi objektive për të gjetur të dhëna të tjera që vërtetojnë marrëdhënien e punësimit dhe kërkon të trajtohet pamundësia e sigurimit të dokumentacionit

për pagimin e detyrimeve tatimore që vjen nga marrëdhënia e punës, bazuar në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

33.3. Subjekti ka depozituar:

- 1) letër rekomandimi datë 17.8.2000, në gjuhën angleze (përkthyer dhe noterizuar) të Misionit të Monitorimit të Komunitetit Evropian – sipas kësaj shkresë subjekti ka punuar si përkthyes nga tetori i vitit 1999 pranë kësaj organizate;
- 2) letërkëmbim me Prezencën e Bashkimit Evropian në Shqipëri, nga ku rezulton se i është kërkuar informacion shtesë nga ana e BE-së në lidhje me punësimin e subjektit në ECMM;
- 3) letër referencë datë 2.6.2001, e Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit (përkthyer dhe noterizuar), sipas të cilës subjekti ka punuar për periudhën 1.2.2001 – 23.7.2001

33.4. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit se institucionet ku ka punuar subjekti nuk ekzistojnë më, nuk mund të përfshijë në analizë financiare një shumë të caktuar të ardhurash, për sa kohë nuk provohet vlera e pagave të përfituar nga subjekti, si dhe nuk ka asnjë të dhënë për paga reference.

33.5. Komisioni ka ribërë analizën financiare në lidhje me këtë apartament, rezultati i së cilës ka ndryshuar, por mbetet sërish me pamjaftueshmëri financiare në shumën 3.237.925,30 lekë.

33.6. Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “D.B”, Tiranë, në pronësi të babait të subjektit, të krijuar tri vite përpara se subjekti të fillonte detyrën, Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit se subjekti nuk ka të drejta reale mbi këtë apartament, për sa kohë që babai i tij është person i lidhur, në kuptim të nenit 3/13 të ligjit nr. 84/2016, pasi bën pjesë në certifikatën familjare të tij, ai ka detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për blerjen e pasurisë apartament.

33.7. Për sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen pasurisë apartament, si dhe nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Si rrjedhojë, – përpos nivelit të përgjegjshmërisë dhe të pasojave konkrete që mund të shkaktojnë problematikat e konstatuara në këtë pasuri, për shkak të faktit se ajo është krijuar përpara se subjekti të fillonte detyrën dhe mungesa e kontributit të tij financiar në krijimin e saj – si përfundim ka rezultuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

34. Automjet tip “M-B *D”, blerë¹⁹ në datën 19.9.2001,** vit prodhimi 1988. Kontrata është bërë për shumën 450.000 lekë, pasi nuk është përfshirë zhdoganimi në shumën 157.525 lekë dhe shpenzimet për riparim. Automjeti është shitur në datën 21.2.2009, në shumën 700.000 lekë, pasi iu bë remont total dhe në kohën e shitjes taksa doganore ka qenë e lartë. Kopje e kontratës së shitjes në Itali dhe vërtetimi i zhdoganimit. Shuma e blerjes: 450.000 lekë. Shitur në shumën 700.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

34.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: blerë me të ardhurat e babait dhe të subjektit.

Hetimi²⁰/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

¹⁹ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2009; dhe (ii) vërtetim zhdoganimi + deklaratë doganore.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 18.12.2019, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.12.2020, e DPSHTRR-së.

35. Subjekti e ka përfituar automjetin²¹ e mësipërm me kontratën e dhurimi nr. ****, datë 19.9.2001, nga shtetasi P.L. Në datën 21.2.2009, me kontratën e shitjes nr. *** ky automjet është shitur në vlerën 700.000 lekë.

35.1. Në deklaratat periodike vjetore, si dhe në përgjigje të pyetësorëve nga Komisioni, subjekti e ka deklaruar këtë automjet si vijon:

- i. në DVP/2003 subjekti deklaroi automjet tip “M-B” në vlerën 800.000 lekë me të ardhura nga puna dhe prindërit;
- ii. në DVP/2004 subjekti deklaroi automjet tip “M-B” i vitit 1988, me targa TR **** J, blerë nga shtetasi P.L, në vlerën 450.000 lekë, në shtator të vitit 2001;
- iii. në DVP/2008 deklaroi të njëjtin automjet në shumën 800.000 lekë si burim për blerjen nga të ardhurat personale si asistent i zyrës rajonale të OSBE-së dhe KE-së;
- iv. në lidhje me këtë automjet, bazuar në procesverbalin e datës 25.3.2009 në ILDKPKI²², subjekti ka sqaruar se është blerë në vitin 2001 në shumën 450.000 lekë dhe është shitur në vitin 2009 në shumën 700.000 lekë. Si burim për këtë automjet ka deklaruar të ardhurat e tij nga pagat në vitet 1999 - 2001 nga puna në UNHCR dhe nga puna pranë Misionit Vëzhgues të BE-së dhe më pas në OSCE deri në vitin 2002;
- v. në përgjigje të pyetësorit të datës 1.6.2020, subjekti ka deklaruar se *automjeti ka kushtuar 450.000 lekë, plus doganë 157.525 lekë dhe bashkë me riparimet ka kapur vlerën 800.000 leke. Në vitin 2003 ka deklaruar vlerën totale të automjetit. Në vitin 2004 ka deklaruar vetëm vlerën fillestare pa doganë dhe riparime, ndërsa në vitin 2008 të gjithë shpenzimet të cilat janë bërë me paratë e kursyera nga puna në OSBE dhe KE. Shkaku i deklarimeve të ndryshme për çmimin ka qenë paqartësia në përpilimin e deklaratave fillestare të pasurisë;*
- vi. në përgjigje të pyetësorit të datës 9.12.2020, subjekti ka sqaruar se *duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes së automjetit, doganën dhe riparimet rezulton se vlera e shitjes është më e ulët se vlera e blerjes. Automjeti ka kushtuar 450.000 lekë, plus doganë 157.525 lekë, dhe bashkë me riparimet ka kapur vlerën 800.000 lekë. Automjeti është shitur në vlerën 700.000 lekë, pra 100.000 lekë më pak sesa vlera totale e tij, ku përfshihej blerja, dogana dhe riparimet. Shitja e mjetit me çmimin e lartpërmendur nuk i nënshtrohej tatimit mbi fitimin për këto arsye: **ligji nr. 8977, datë 12.12.2002**, në nenin 3, pika 20, ka parashikuar: “Taksa e kalimit të pasurive të paluajtshme e automjeteve”. Kjo lloj takse u shfuqizua me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008. Subjekti deklaroi se është në dijeni të parashikimeve ligjore të **ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998**, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në nenin 4 janë parashikuar edhe “të ardhura të tjera”. Gjithmonë sipas kuptimit të tij, kjo bazë ligjore nuk mund të përdoret, pasi me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, është parashikuar një taksë e drejtpërdrejtë mbi automjetet që është shfuqizuar nga ligjvënësi dhe nuk mund të përdoren dispozita të përgjithshme të ligjit për “Tatimin mbi të ardhurat”. Subjekti deklaroi se nuk e ka paguar detyrimin tatimor në gjykimin e tij automjeti është shitur me humbje. Subjekti deklaroi se remontin e automjetit e ka bërë në dhjetor të vitit 2007 në vlerën 200.000 lekë.*

35.2. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ****, datë 16.12.2020, të blerësit të automjetit, z. B.P, i cili ka deklaruar se automjeti që ka blerë, ka pasur remont në një vlerë prej 215.000 lekësh.

²¹ Bazuar në deklaratën doganore import *, datë 20.9.2001, vlera e automjetit është 7.000.000 lireta dhe detyrimet doganore 157.211 lekë.

²² Shihni shkresën kthim përgjigjen nr. **** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së.

35.3. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë automjet: (i) subjekti nuk ka deklaruar saktë automjetin tip “M-B” në deklaratën “Vetting”, pasi rezulton se ky automjet i është dhuruar dhe jo blerë; (ii) në analizën financiare nuk do të përfshihet shuma e pretenduar si e përfituar nga shitja e automjetit në vlerën 700.000 lekë, pasi nuk rezulton që subjekti të ketë paguar detyrimet tatimore. Gjithashtu, në analizë nuk do të përfshihet edhe shuma e blerjes së automjetit.

35.4. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, prapësoi se kontrata e dhurimit me nr. ****, datë 19.9.2001, nga shtetasi P.L u realizua për arsyen e marrëveshjes verbale që babai i tij kishte bërë me këtë shtetas. Shërbimet që i ati do të kryente për evidentimin e pronësisë dhe saktësimin e tokave që babai i këtij shtetasi kishte në fshatin Gjoricë të rrethit Bulqizë do të kompensoheshin me dhurimin e këtij automjeti. Duke qenë se shtetasi P.L nuk arriti t’i japë dokumentacionin e duhur për evidentimin e pronësisë mbi tokën, ndërmjet palëve u ra dakord që automjeti do të shitej, pasi shërbimi nuk do të ofrohej më. Për shkak se ky shtetas ishte dhe vazhdon të jetë rezident në Itali, anulimi i kontratës së dhurimit dhe lidhja e kontratës së shitblerjes do të bëhej kur ky shtetas të rikthehej përsëri në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht se nga ana formale nuk pasqyrohet blerja, por dhurimi për këtë automjet, subjekti si në DPV-në para fillimit të detyrës, ashtu edhe në DPV-në e vitit 2003, si dhe në vazhdim, ka deklaruar se automjeti tip “M-B *** D” ka kushtuar gjithsej 800.000 lekë. Ai ka deklaruar vlerën faktike të blerjes së automjetit, ndonëse pronësia për këtë automjet i është transferuar me dhurim dhe jo shitje, sikurse ka qenë realisht.

35.5. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasit P.L (në gjuhën italiane dhe të përkthyer në shqip, por e panoterizuar, pa vulë apostile dhe përkthim i panoterizuar), në të cilën ky shtetas ka deklaruar se: *“Në vitin 2001 i ka shitur z. Bledar Maksuti një automjet tip ‘M-B’ në shumën 450.000 lekë. Fillimisht marrëveshja u bë me babain e z. Bledar, z. P.M, i cili ushtronte detyrën e noterit në qytetin e Peshkopisë. Kjo marrëveshje verbale konsistonte që pagesa e automjetit të bëhej nga ana e z. P jo me para në dorë, por me shërbim juridik dhe noterial për të evidentuar pronësinë dhe saktësimet e tokave që ai kishte në emër të babait në fshatin Gjoricë të rrethit Bulqizë. Për këtë arsye, duke qenë se pagesa nuk do të bëhej cash por me shërbime juridike, u ra dakord të bëhej një kontratë dhurimi të automjetit me përfitues z. Bledar Maksuti, duke qenë se brenda muajit nuk arriti t’i japë z. P dokumentacionin e duhur. [...] atëherë ra dakord që mjete të shitej. Në këto rrethana z. P.M i ka dhënë shumën prej 450.000 lekësh me premtimin që sapo të vinte në Shqipëri të bënin kontratën e shitjes dhe anulimin e kontratës së dhurimit. Ky veprim nuk u bë për shkak edhe të mungesës së udhëtimit tim në Shqipëri, edhe për shkak të neglizhencës apo harresës”.*

35.6. Shpjegimet e subjektit në lidhje me kontratën e dhurimit ndonëse mund të jenë reale, ato nuk mbështeten në prova. Subjekti pretendon se ai e ka blerë automjetin, por nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar këtë deklaram të tij. Për më tepër, subjekti ka pasur të gjitha mundësitë për të sqaruar këtë situatë në deklaratën “Vetting”, po ashtu mund ta sqaronte edhe kur është pyetur nga Komisioni, por nuk e ka deklaruar asnjëherë faktin që ky automjet ishte përfituar me kontratë dhurimi.

35.7 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasqyruar saktë në deklaratën “Vetting” mënyrën e fitimit të pasurisë tip “M-B *** D”, pasi rezulton se ky automjet i është dhuruar dhe jo blerë prej tij. Në analizën financiare nuk do të përfshihet shuma e pretenduar si e përfituar nga shitja e automjetit në vlerën 700.000 lekë, pasi nuk rezulton që subjekti të ketë paguar detyrimet tatimore.

35.8. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

36. Automjet tip “M-B ** D”²³**, vit prodhimi 2002, blerë në mars të vitit 2009, në vlerën 8.500 euro. Ky automjet i është shitur vjehtë të subjektit, N.D, në datën 15.4.2015, në vlerën 5.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

36.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit të mëparshëm (automjet tip “M-B *** D”) dhe të ardhurat e babait nga puna.

Hetimi²⁴/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

37. Subjekti ka blerë në datën 12.3.2009 automjetin tip “M-B”, në shumën 8.500 euro. Bazuar në deklaratën doganore import 4 të datës 13.3.2009, detyrimi doganor është në shumën 458.347 lekë. Me anë të kontratës së shitjes nr. *****, datë 15.4.2015, ky automjet është shitur në vlerën 5.000 euro.

37.1. Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me blerjen e këtij automjeti, në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 6

	Mars 2009
PASURI	1,129,291
Automjet tip “M-B ****D”	1,172,660.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	-43,368.77
Likuiditete gjendje	170,101.86
DETYRIME	-11,791.87
Kredi konsumatore nëpërmjet N, 2 vjet	-11,791.87
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	1,141,083.0975
TË ARDHURA, dokumentuar	634,987.02
Të ardhura nga paga e subjektit	259,590.88
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	300,000.00
Pensioni i nënës	36,540.63
Pensioni i babait	38,855.51
Të ardhura nga shitja e pasurive	
SHPENZIME	107,790
Shpenzime jetese	102,465
Udhëtime sipas sistemit TIMS	1,380
Paguar interesa kredie	3,946
Mundësia për kursime	-613,886.18

²³ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 15.4.2015; dhe (ii) deklaratë doganore e vitit 2009.

²⁴ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.12.2019, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 24.12.2020, e DPSHTRR-së.

37.2. Nga analiza financiare e lartpërmendur rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën -613.886,18 lekë, pasi shuma 700.000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit tip “M-B *** D”, të sipërtrajtuar, nuk është përfshirë në analizë financiare.

37.3. Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, subjekti pretendoi se Komisioni duhet të përfshijë në analizë financiare vlerën e shitjes së automjetit tip “M-B *** D”, pasi referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Udhëzimit nr. 5, në zbatim të tij, fitimi kapital nga dhurimi është parashikuar për herë të parë me ndryshimin që ka pësuar ligji nr. 8438, sipas ligjit nr. 10343, datë 28.10.2010. Parashikimi ligjor për herë të parë për tatimin e të ardhurave nga dhurimi është bërë në fund të vitit 2010 për individët që duhet të deklaronin DIVA për herë të parë në vitin 2011. Deri në këtë periudhë të ardhurat e realizuara nga shitja e një pasurie të luajtshme të dhuruar nuk tatoheshin, pasi edhe sikur të kërkoje të paguaje detyrimin tatimor ishte e pamundur forma dhe mënyra e pagesës. Në analizë nuk është marrë në konsideratë mundësia për kursim e babait të subjektit deri në këtë periudhë dhe gjendja *cash* që ka disponuar.

37.4. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Ai nuk vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë, shuma 700.000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit tip “M-B *** D” nuk do të përfshihet në analizë financiare, duke e venë subjektin në kushtet e pamundësisë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e këtij automjeti.

37.5. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë së mësipërme, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

38. Automjet tip “V. Sh 2.0”²⁵, vit prodhimi 2009, me vlerë 9.250 euro + 266.550 lekë taksë doganore. Pjesa takuese: 100 %.

38.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga shitja e automjetit të parë tip “M-B” në shumën 5.000 euro, shitur shtetasit N. D, ndërsa diferenca nga të ardhurat familjare.

Hetimi²⁶/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

39. Në datën 6.7.2015 subjekti ka depozituar shumën 9.250 euro²⁷ në llogarinë e tij në BKT. Në po të njëjtën datë është transferuar shuma 9.200 euro te shoqëria “D.A” për blerjen e automjetit²⁸ tip “V. Sh”.

39.1. Në datën 13.7.2015, bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “R. B” rezulton se ai ka depozituar shumën 267.000 lekë dhe në po të njëjtën datë ka paguar detyrimet për zhdoganimin e automjetit në vlerën 266.550 lekë.

²⁵ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) autorizim datë 7.7.2015; (ii) letër të thjeshtë me vulë të shoqërisë “D. A”; (iii) të dhëna nga shoqëria “D.A” për automjetin “V.Sh”, vlera 9.250 euro; (iv) mandatdepozitimi datë 6.7.2015, në BKT; dhe (v) njoftim debitimi datë 13.7.2015, “Raiffeisen Bank”.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.5.2020, nga BKT; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 10.12.2010, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 18.12.2019, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 24.12.2020, e DPSHTRR-së.

²⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.5.2020, nga BKT-ja.

²⁸ Deklaruar në DVP/2015.

39.2. Komisioni ka kryer analizën financiare në lidhje me këtë automjet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 7

	6 korrik 2015
PASURI	1,855,898
Automjet “V. Sh”	1,269,840
Shtesa/pakësime, likuiditete	586,058.05
Likuiditete gjendje	6,100,342.84
TË ARDHURA, dokumentuar	2,072,795.49
Të ardhura nga paga e subjektit	785,871.33
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	372,598.92
Pensioni i nënës	87,738.67
Pensioni i babait	95,540.13
Shpërblime për lindjen e fëmijëve (nga Bashkia)	10,000
Të ardhura nga interesat bankare	34,646
Të arkëtuara nga shitja e automjetit “M-B ***D”	686,400
SHPENZIME	839,191
Shpenzime jetese	672,828
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	55,236
Paguar karta e kreditit	11,127
Blerje mallrash/pajisje elektroshtëpiake	100,000
Mundësia për kursime	-622,293.23

39.3. Nga analiza financiare e lartpërmendur rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën -622.293,23 lekë.

39.4. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi duke deklaruar se si burim ka shërbyer gjendja *cash* në shumën 800.000 lekë që ka pasur në banesë, e cila më pas u zëvendësua me kursimet ndër vite. Subjekti pretendon se si burim ka shërbyer edhe gjendja *cash* e babait, për të cilën sipas deklarimeve të tij nuk ka pasur informacion.

39.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Është e vërtetë që nëse do të përfshihej shuma 800.000 lekë si gjendje *cash* nga subjekti, ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti, por ndërkohë, nga analiza e vitit 2015 rezulton se ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 800.000 lekë.

39.6. Në lidhje me gjendjen *cash* të babait të subjektit, Komisioni e ka analizuar në detaje në pikën 39.7.1 këtij vendimi.

40. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë tip “V. Sh, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

41. Garazh në pallatin²⁹ ku jeton familja e subjektit, në vlerën 6.000 euro, blerë në datën 29.4.2016. Garazhi është hipotekuar dhe regjistruar në emër të babait të subjektit, z. P. M.

41.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e babait dhe kursimet familjare.

Hetimi³⁰/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

42. Në datën 29.4.2016, me kontratën e shitjes nr. ****, babai i subjektit ka blerë garazh³¹ me sip. 16.2 m², me vlerë 6.000 euro. Pagesa vërtetohet me mandatarkëtimin datë 29.4.2016, të NBG Bank, në shumën 6.000 euro. Bazuar në shkresën e ASHK-së rezulton se ky garazh ka nr. pasurie ***-G*, z. k. ****, në pronësi të z. P.M, babait të subjektit.

42.1. Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me këtë pasuri, si vijon:

Tabela nr. 8

	Datë 29.4.2016
PASURI	310,192
Garazh në pallatin ku banon subjekti	811,380
Shtesa/pakësime, likuiditete	-501,188
Likuiditete gjendje	5,134,903
TË ARDHURA, dokumentuar	922,988
Të ardhura nga paga e subjektit	412,880
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	160,240
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	226,334
Pensioni i nënës	59,170
Pensioni i babait	64,365
SHPENZIME	1,191,726
Shpenzime jetese	548,548
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	247,200
Blerje mallrash/pajisje elektroshtëpiake	333,477
Shpenzime kopshti për vajzën I	31,250
Shpenzime kopshti për vajzën M	31,250
Mundësia për kursime	-578,929

42.2. Nga analiza financiare e sipërcituar rezulton se babai i subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën -578.929 lekë.

42.3. Subjekti pretendon se mbi këtë pasuri nuk ka të drejta pronësi apo reale dhe, për rrjedhojë, nuk ka interesa pasurore. Subjekti pretendon se duhet të merret në konsideratë mundësia për

²⁹ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 9.5.2016; (ii) kontratë shitjeje nr. **** rep., nr. **** kol., datë 29.4.2016.

³⁰ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2109, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigjeje e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri.

³¹ Deklaruar në DVP/2016.

kursim e babait të tij deri në vitin 2014, e cila sipas pretendimeve të subjektit është në shumën 5.580.029 lekë.

42.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se është i drejtë konstatimi i tij që nuk ka të drejta reale mbi këtë pasuri, por ndërkohë është ai që e përdor këtë pasuri, pasi babai i tij nuk ka automjet në pronësi. Pavarësisht faktit të të drejtave të subjektit mbi këtë pasuri, babai i tij është person i lidhur, në kuptim të nenit 3/13 të ligjit nr. 84/2016, pasi është pjesë në certifikatën familjare të subjekti dhe, për rrjedhojë, ky i fundit ka detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për blerjen e pasurisë garazh.

42.5. Në lidhje me kursimet *cash* ndër vite të babait, ato nuk janë marrë në konsideratë, bazuar në analizën e bërë në pikën 39.7.1 të këtij vendimi.

42.6. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë garazh në pronësi të babait të tij.

42.7. Si rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë garazh, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

43. Llogari bankare në “C. B”³², me nr. *****, ku kalon paga. *Statement*-i i bankës datë 26.1.2017. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi³³/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

43.1. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “C.B” gjendja në datën 10.1.2017 është në shumën 1.430 lekë.

Nga hetimi nuk kanë rezultuar pasaktësi apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare.

43.2. Llogari kursimi³⁴ në BKT, me interes, me gjendje 3.034.646,45 lekë, në emër të nënës së subjektit, znj. M.M.

43.2.1. Gjendja aktuale e llogarisë me nr. IBAN AL*****E është 3.034.646 lekë.

43.3. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: llogaria është hapur në datën 30.3.2012 dhe është bërë nga llogaria e mëparshme e nënës në po të njëjtën bankë, plus kursimet nga të ardhurat e punës së babait. Kjo shumë ka qenë e derdhur që në vitin 2005, por një pjesë u tërhoq për të ndihmuar të afërmit dhe u depozitua sërish.

Hetimi³⁵/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

44. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së përbashkët të subjektit dhe nënës së tij³⁶ në BKT, rezulton se subjekti ka depozituar në datën 30.3.2012 *cash* shumën 3.000.000 lekë. Kjo shumë është transferuar në datën 10.4.2015 në një tjetër llogari të përbashkët të subjektit dhe nënës së tij.

44.1. Në lidhje me depozitim e shumës 3.000.000 lekë, subjekti ka deklaruar se e ka burimin nga llogaria e mëparshme e nënës së tij, plus kursimet nga të ardhurat e babait. Kjo shumë ka qenë e derdhur që në vitin 2005, por një pjesë u tërhoq për të ndihmuar të afërmit.

³² Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, e “Credins Bank”.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. ***** prot., datë 26.12.2019, e “Credins Bank”.

³⁴ Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, e BKT-së, për depozitë në emër të shtetasve M ose B.M, në shumën 3.034.646 lekë.

³⁵ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

³⁶ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 20.5.2020 dhe shkresën nr. **** prot., datë 26.6.2020, të BKT-së.

44.2. Subjekti, në lidhje me këtë shumë, ka depozituar në ILDKPKI³⁷ librezën e depozitës së llogarisë së znj. M. M në BKT, nga ku rezultojn se:

- në datën 6.9.2005 është derdhur shuma 500.000 lekë;
- në datën 8.9.2005 është derdhur shuma 2.300.000 lekë;
- në datën 27.11.2008 është tërhequr shuma 1.009.076 lekë;
- në datën 30.3.2012 mbyllet llogaria në BKT, duke u tërhequr shuma e mbetur prej 574.280 lekësh.

44.3. Komisioni administroi dokumentacionin në lidhje me llogarinë bankare³⁸ të znj. M. M, nga ku rezultojn se në datën 6.7.2006 është tërhequr shuma 1.000.000 lekë. Në lidhje me këtë shumë subjekti pretendon se i është dhënë hua z. V.M, i cili e ka kthyer në vitin 2009.

44.4. Komisioni ka hetuar në lidhje me mundësinë e z. V. M për të kthyer huan dhe nga hetimi ka rezultuar se ai nuk ka pasur mundësi financiare për kthimin e saj.

44.5. Dhënia e kësaj huaje nuk rezultojn të jetë deklaruar nga personi i lidhur, znj. M.M, në DVP/2008, por edhe kthimi i saj në DVP/2009, për rrjedhojë, Komisioni nuk do ta përfshijë shumën 1.000.000 lekë në analizën financiare për periudhën 2008 e në vijim.

44.6. Analiza financiare

Tabela nr. 9

	Datë 30.3.2012
PASURI	3,616,714.72
Depozita në BKT	3,000,000.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	616,714.72
Likuiditete gjendje	961,417.2
TË ARDHURA, dokumentuar	1,220,628.75
Të ardhura nga paga e subjektit	247,106.75
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	124,347.00
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	480,000.00
Pensioni i nënës	40,953.54
Pensioni i babait	44,864.26
Interesa të përfituara	283,357.21
SHPENZIME	139,548.00
Shpenzime jetese	139,548.00
Mundësia për kursime	-2,535,633.97

44.7. Nga analiza financiare rezultojn se subjekti dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.535.633,97 lekë për depozitimin e shumën 3.000.000 lekë.

³⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2020

³⁸ Shkresë nr. ***** prot., datë 29.12.2020, e BKT-së.

44.8. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DVP/2008 dhënien e huas në shumën 1.000.000 lekë shtetasit V. M, si dhe nuk ka deklaruar kthimin e huas në DVP/2009; (ii) subjekti nuk provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit V.M për kthimin e huas, për rrjedhojë, shuma 1.000.000 lekë nuk do të përfshihet në analizën financiare; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në DVP/2008 e në vijim kursime *cash*; (iv) nëna e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 2.535.633,97 lekë për kryerjen e depozitës në shumën 3.000.000 lekë.

44.9. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se ai nuk ka të drejta pronësie apo të drejta reale dhe, për rrjedhojë, nuk ka interes pasuror mbi këtë llogari bankare. Subjekti pretendon se nëna e tij nuk ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë në deklaratat periodike dhe të konsiderohet person i lidhur. Subjekti pretendon se në analizë duhet të përfshihen gjendja *cash* e babait të subjekti nga data e emërimit në detyrë deri më 30.3.2012, huaja e kthyer nga shtetasi V.M, tërheqjet nga banka në vitin 2008 në shumën 1.009.076 lekë, tërheqja në datën 30.3.2012 në shumën 574.280 lekë, si dhe huat e kthyer nga motrat në shumën 45.000 euro.

45. Komisioni ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në lidhje me mundësitë financiare të shtetasit V. M. Kësaj analize iu nënshtrua “deklarata noteriale nr. *****, datë 17.3.2021” e këtij shtetasi, i cili ka deklaruar se *në verën e vitit 2006 i ka marrë xhaxhait të tij P. M shumën 1.000.000 lekë. Shuma i është dhënë cash pa dokument, në mirëbesim dhe ia ka kthyer diku nga fillimi i vitit 2009, por pa dokument, në mirëbesim cash... Këtë hua e ka shlyer ai personalisht nga puna me dokumente të rregullta dhe taksapagues në Republikën e Greqisë, si dhe vëllezërit e tij R, A dhe M. M të cilët edhe ata kanë qenë dhe janë me dokumente të rregullta dhe punojnë në Republikën e Greqisë”.*

45.1. Bashkëlidhur deklaratës gjenden:

- a. kopje të pjesës së pasaportës së z. V. M me lejen përkatëse të shtetit grek;
- b. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2009 të z. V. M – të ardhurat e përfituara 9.000 euro;
- c. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2008 të z. V.M – të ardhurat e përfituara 9.000 euro;
- d. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2007 të z. V. M – të ardhurat e përfituara 7.000 euro;
- e. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2006 të z. V. M – të ardhurat e përfituara 5.000 euro;
- f. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2005 të z. V.M – të ardhurat e përfituara 4.000 euro;
- g. deklaratë tatimore të ardhurash të personave fizikë në bazë të deklaratës fillestare (pa vulë apostile, por e përkthyer dhe e noterizuar) për periudhën tatimore të vitit 2004 të z. V. M – të ardhurat e përfituara 4.000 euro.

45.2. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë me dokumentacion provues ligjor që z. V.M ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huas në shumën 1.000.000 lekë dhe Komisioni vlerëson ta marrë në konsideratë këtë shumë. Ndërkohë, në lidhje me pretendimet e tjera të subjektit, Komisioni vlerëson të mos i marrë në konsideratë, për arsye se subjekti:

- i. është bashkëpronar me nënën e tij në këtë llogari bankare, për rrjedhojë, ka të drejta pronësie mbi këtë pasuri;
- ii. ka depozituar shumën 3.000.000 lekë në llogarinë e përbashkët të tij dhe të nënës;
- iii. në të gjitha deklaratat periodike vjetore ka deklaruar rregullisht të ardhurat e prindërve;
- iv. ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit, si dhe ka jetuar me ta.

45.3. Në përfundim, edhe pas përfshirjes në analizë të shumës 1,000,000 lekë, sërish subjekti dhe familjarët e tij nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme depozitim të të gjithë shumës prej 3,000,000 lekë, pasi rezulton një pamundësi financiare në shumën 1,535,633.97 lekë. Për sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e plotë të llogarisë së kursimit dy emërore të tij dhe nënës së tij në BKT.

45.4. Si rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e llogarisë së kursimit në BKT, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës b të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

46. Llogari bankare në vlerën 1.000.000 lekë³⁹, në BKT. Pjesa takuese: 50 %.

46.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura të dhëna nga babai dhe nëna e bashkëshortes para martesë, si dhe para të grumbulluara si dhuratë për lindjen e tre fëmijëve. Shuma 800.000 lekë është deklaruar që në vitin 2011. Këto para janë derdhur në një llogari të përbashkët me bashkëshorten E.M në BKT me nr. IBAN AL*****.

46.2. Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të prindërve të bashkëshortes për shumën totale prej 1.900.000 lekësh në vitin 2011.*

Hetimi⁴⁰/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

47. Në datën 23.1.2017, bazuar në mandatarkëtimin e BKT-së, subjekti ka depozituar shumën 1.000.000 lekë në llogarinë e tij. Kjo shumë është transferuar nga llogaria e tij në llogarinë e përbashkët të tij dhe të bashkëshortes në BKT në po të njëjtën datë.

47.1. Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2011 (vit kur subjekti është martuar) bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogari në “Credins Bank”, të dhuruara nga nëna në vitin 2010 në vlerën 1.100.000 lekë dhe para *cash* të kursyera të dhënë nga prindërit në vlerën 800.000 lekë.

47.2. Në lidhje me burimin e shumës 1.000.000 lekë, subjekti ka deklaruar se është nga kursimet *cash* të deklaruara në vitin 2011 në shumën 800.000 lekë dhe shuma 200.000 e grumbulluar si dhuratë për lindjen e tre fëmijëve.

47.3. Komisioni ka kryer një hetim mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes së bashkëshortes, nga ku rezulton se:

- i. QKB-ja⁴¹ informon se shtetasi N. D, figuron:
 - a. administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “D” sh.p.k., datë regjistrimi 20.1.1995, me NIPT J*****F;

³⁹ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) mandatarkëtim datë 23.1.2017, të BKT-së; dhe (ii) nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, e BKT-së.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, drejtuar BKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.12.2020 BKT.

⁴¹ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 13.12.2019

- b. administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “S” sh.p.k., i regjistruar me vendimin nr. *****, datë 5.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT;
 - c. administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “M.U” sh.p.k., i regjistruar me vendimin nr. *****, datë 1.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT;
 - d. përfaqësues ligjor në subjektin “D” me NIPT K****H, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në QKB.
- ii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, me shkresën nr. ***** prot., datë 24.12.2020, nuk konfirmon të ardhura për shoqëritë e mësipërme.
- iii. Referuar shkresës nr. ***** prot., datë 23.12.2020, të DRT-së Tiranë, administruar nga Komisioni, e cila informon mbi:
- fitimin e shoqërisë “D” sh.p.k., i cili për periudhën 2008 – 2013 është 0 (zero);
 - pagat e administratorit N.D nga janari i vitit 2012 e në vijim, periudhë kjo para momentit të dhënies së dhuratës.

Detyrimet e shoqërisë deri në datën 23.12.2020 janë në vlerën 254,8936 lekë.

47.3. Komisioni gjithashtu i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion provues në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. N.D. Nga ana e tij subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit lëvizjet e llogarisë në “Union Bank” të shoqërisë “D” sh.p.k, ku tregohen shumat e debituar dhe kredituar në euro, nga data 1.1.2006 deri më 31.12.2010. Nga përshkrimet e vendosura në këto lëvizje rezultojnë shuma të konsiderueshme në euro, të cilat kreditohen/derdhen nga UFT⁴² (U.F.T). Nga shqyrtimi i kësaj llogarie bankare rezulton se shoqëria “D” sh.p.k. ka qarkullim vjetor⁴³ nga 200.000 euro deri në 1.500.000 euro/vit.

47.4. Bazuar nga sa më sipër, subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhurat nga paga e babait të bashkëshortes për periudhën e analizuar, as fitim dhe/ose shpërndarjen e dividendit nga shoqëria “D” sh.p.k.

47.5. Komisioni, në lidhje me burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”, vlerëson të mos i marrë në konsideratë, pasi:

- i. Subjekti për herë të parë deklaroi se ka pasur të ardhura nga familjarët në shumën 200.000 lekë për lindjen e fëmijëve, shumë e cila nuk rezultoi të jetë deklaruar në DVP-të përkatëse, por vetëm në deklaratën “Vetting”.
- ii. Sa i takon shumës 800.000 lekë, bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar në DPV/2011, si *para cash të kursyera, të dhëna nga prindërit*, por subjekti nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes së saj.

47.6. Në përfundim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për depozitim të shumës 1.000.000 lekë, pasi nuk provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave të deklaruara prej tij.

⁴² Mënyra e operimit të UFT-së bazohet në marrëveshjen midis saj dhe agentit Western Union (WU) për ofrimin e shërbimit të transfertës së parave nëpërmjet WU. Shoqëria “D” sh.p.k. duket se është agent i W.U dhe kalimet nga UFT tek shoqëria “D” sh.p.k. kanë të bëjnë me rimbursimin e pagesave që ka bërë agjenti. Kështu, agjenti përdor gjendjen e tij *cash* për të paguar klientët marrës/pritës të WU dhe pas rakordimit UFT-ja i rimburson agjentit këto shuma.

⁴³ Ky është qarkullim i pjesshëm, pasi shumat e sjella nga UFT-ja janë pas rakordimit të WU-së së transfertave në nisje dhe mbërritje.

47.7. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se vjehri i tij, z. N.D, ka pasur llogari depozite në BKT, me nr. llogarie ****, në monedhën USD. Nga transaksionet që pasqyrohen në *statement*-in bankar të kësaj llogarie konstatohet se ka disa transaksione si: blen euro dhe më pas shet euro duke blerë USD. Veprimet e shitblerjes në monedha të huaja kanë filluar që prej shtatorit të vitit 2005. Në periudha të ndryshme ka përfutuar edhe të ardhura nga interesat për depozitat e krijuara. Fitimet nga kursi i këmbimit dhe të ardhurat nga interesat janë tërhequr në datën 29.3.2007, në shumën 30.000 USD. Përveç transaksioneve në BKT, shtetasi N. D ka realizuar edhe të ardhura nga paga *neto* sipas vërtetimit të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore. Kështu, me shkresën nr. ****, datë 30.3.2021, të ISSH-së, dega rajonale Shkodër, konfirmon pagesën e sigurimeve shoqërore, duke bashkëlidhur edhe tabelën përkatëse. Nga pasqyrat financiare të viti 2007 të shoqërisë “*****” sh.p.k., me NIPT J*****F, rezulton në aktiv zëri “të tjera kërkesa” në vlerën 1.148.118 lekë, që përfaqëson tërheqjet e ortakut në shoqëri. Ky zë tregon se shoqëria ka një të drejtë ndaj ortakut të saj për shumën e të hollave të tërhequra prej tij.

47.8. Subjekti ka depozituar:

- i. nxjerrje llogarie datë 24.3.2021, të “Credins Bank” të bashkëshortes, ku në datën 25.9.2010 ka depozituar *cash* shumën 1.011.600 lekë dhe në datën 26.9.2012 kjo shumë është transferuar në llogarinë e znj. V. D, nëna e bashkëshortes;
- ii. llogari në lekë të shoqërisë “D” sh.p.k., z. N.D, në BKT;
- iii. llogari në USD, të z. N. D, në BKT;
- iv. llogari në euro të shoqërisë “D” sh.p.k., z. N.D, në BKT;
- v. vërtetim nr. ***, datë 26.3.2021, i Unionit Financiar Tiranë, nëpërmjet të cilit konfirmohen komisionet e përfuturara nga subjekti “D” sh.p.k. në kuadrin e shërbimit W. U si agjent i U.F.T sh.a., për periudhën janar 2002 –shkurt 2010, komisionet për periudhën 2002 – 2004 janë në total në shumën 87.695,92 USD, ndërsa për periudhën 2004 – 2010 janë në shumën 136.320,52 euro;
- vi. pasqyrat financiare për vitet 2006 – 2007;
- vii. shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2021, të ISSH-së, Drejtoria Rajonale Shkodër, në lidhje me periudhën e deklaramit si i siguruar të z. N.D pranë subjektit “D”.

47.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, konstaton se nga dokumentacioni provohet që shoqëria “D” sh.p.k. ka pasur të ardhura të konsiderueshme, po ashtu edhe babai i bashkëshortes së subjektit ka lëvizje bankare në vlera të konsiderueshme, duke u provuar në këtë mënyrë të ardhurat e tij, por ndërkohë subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me këto burime financiare.

48. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë bankare në BKT.

48.1. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e llogarisë bankare në BKT, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

49. Llogari bankare në BKT⁴⁴, me nr. IBAN AL*****Y, e hapur fillimisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin për hedhjen e pagës dhe më pas është përdorur nga universiteti “E” dhe universiteti “B” për hedhjen e pagës si pedagog *part-time*. Gjendja në llogari në datën 24.1.2017 është 27.416,48 lekë.

⁴⁴ Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie në datën 24.1.2017, në BKT.

Hetimi⁴⁵/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

50. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se në datën 23.1.2017 gjendja e kësaj llogarie është 27.416,48 lekë. Në këtë datë subjekti ka depozituar në llogarinë e tij shumën 1.000.000 lekë, me emërtim “të ardhura të bashkëshortes nga puna dhe familjarët e saj”. Në po të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit.

Nga hetimi nuk kanë rezultuar pasaktësi apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare.

51. Llogari bankare në BKT⁴⁶, me nr. IBAN AL*****V, e pensionit të babait të subjektit, z. P.M.

51.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: gjendja aktuale 3.116.878 lekë pas derdhjes së parave *cash* prej 2.700.000 lekësh të disponuara prej tij në banesë.

Hetimi⁴⁷/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

52. Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit në BKT rezulton se:

- i. në datën 14.8.2015 babai i subjektit ka depozituar shumën 3.000.000 lekë, të cilën në të njëjtën datë ia ka dërguar shtetasit Sh.Ll, me emërtim “parapagim (kapar) për blerje shtëpie karabina” (trajtuar në vijim);
- ii. në datat 18.12.2015 dhe 30.12.2015 shoqëria “M.SH.C.” sh.p.k. i ka depozituar babait të subjektit shumën totale 800.000 lekë (400.000 lekë për secilin depozitim) me emërtim “pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie” (trajtuar në vijim);
- iii. babai i subjektit ka depozituar në datën 24.1.2017 shumën 2.700.000 lekë, me përshkrimin “të ardhura nga puna si noter + kursime”;
- iv. gjendja e kësaj llogarie në datën 24.1.2017 është 3.116.878,96 lekë.

52.1. Në lidhje me shumën 2.700.000 lekë subjekti ka deklaruar se ka qenë në formën *cash* të mbajtur në banesë nga babai i tij.

52.2. Komisioni, në lidhje me këtë shumë, konstaton se babai i subjektit:

- nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore;
- nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën 2.700.000 lekë, referuar analizës financiare.

52.3. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se ai nuk ka të drejta pronësie apo të drejta reale dhe, për rrjedhojë, nuk ka interesa pasurore. Ndërkohë, në lidhje me burimin, subjekti deklaroi se babai i tij nuk ka pasur detyrimin e deklarimit në DPV-të vjetore. Babai i tij, referuar analizës financiare dhe mundësisë së kursimit, duke zbritur nga mundësia çdo vit disa teprica, rezulton se deri në datën 31.12.2016 ka pasur mundësi të ketë kursime *cash* në shumën 4.300.000 lekë.

52.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë të mbështetura në ligj dhe në prova. Babai i subjektit, edhe sikur të merret hipotetikusht që ka pasur kursime *cash* ndër vite, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 2.700.000 lekë. Në lidhje me të drejta reale apo të pronësisë Komisioni vlerëson se konstatimi

⁴⁵ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

⁴⁶ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, në BKT; dhe (ii) mandatarëkëtim datë 24.1.2017, në BKT.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

i subjektit është i drejtë, por ndërkohë babai i tij është në përbërjen e certifikatës familjare dhe, për rrjedhojë, konsiderohet person i lidhur.

52.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për depozitimin e shumës 2.700.000 lekë nga babai i tij.

52.6. Si rrjedhojë, babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme për depozitimin e shumës 2.700.000 lekë në datën 24.1.2017, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

53. Llogari bankare në BKT⁴⁸, me nr. IBAN AL*****B, e babait të subjektit, z. P. M, si person fizik, avokat, në të cilën realizohen pagesat për punën e kryer. Gjendja aktuale: 711.083 lekë.

Hetimi⁴⁹/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

54. Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit në BKT rezulton se gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017 është 711.083 lekë.

Nga hetimi nuk kanë rezultuar pasaktësi apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare.

55. Gjendje cash në shumën 1.400.000 lekë, si trung familjar

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

55. Komisioni ka kryer një analizë financiare për të llogaritur gjendjen *cash* si trung familjar të deklaruar nga subjekti në shumën 1.400.000 lekë.

Tabela nr. 10

	DPV/2017
PASURI	3,399,687.35
Apartament me sip. 133.4 m ² , rr. “D. B”, Tiranë	
Automjet “M-B***D”	
Automjet “V. Sh”	
Garazh në pallatin ku banon subjekti	
“M. D. C. E”	
Dhënë hua nga babai te z. Sh. Ll.	-150,000
Dhënë hua nga babai te nipi Xh. K. (gjatë vitit 2015)	-500,000
Shtesa/pakësime, likuiditete	4,049,687
Likuiditete gjendje	9,362,308
DETYRIME	-265,900.00
Kredi konsumatore nëpërmjet N, 2 vjet	

⁴⁸ Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, e BKT-së, për “P.M”, person fizik.

⁴⁹ Shkresë nr. ***** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***** prot., datë 24.6.2020, e BKT-së.

Pagesat e kredisë, principali	
Marrë hua babai nga "M.SH.C."	-265,900.00
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	3,665,587.35
TË ARDHURA, dokumentuar	194,974
Të ardhura nga paga e subjektit	98,902
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	91,072
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	
Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, babai	
Pensioni i nënës	
Pensioni i babait	
Shpërblime për lindjen e fëmijëve (nga Bashkia)	5,000.00
Të ardhura nga interesat bankare	
Bashkëshortja, të dhuruara nga prindërit para martesës	
Të ardhura nga shitja e pasurive	
Bashkëshortja, të mbartura para martesës	
Likuiditete të mbartura para detyrës	
SHPENZIME	179,514.86
Shpenzime jetese	138,864.86
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	
Paguar interesa kredie	
Paguar karta e kreditit	
Shpenzime kredie RZB/N	
Shpenzime mobilimi/mallra për shtëpinë (sipas pyetësorit standard)	
Blerje mallrash/pajisje elektroshtëpiake	
Shpenzime kopshti për vajzën I	24,350.00
Shpenzime kopshti për vajzën M	16,300.00
Shpenzime në Hipotekë	
Mundësia për kursime	-3,650,129

55.1. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe familjarët e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të pasur kursime *cash* në shumën 1.400.000 lekë.

55.2. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se si burim kanë shërbyer kursimet *cash* të babait të tij, të padeklaruara ndër vite.

55.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë të mbështetura në ligj dhe në prova. Babai i subjektit, edhe sikur të merret hipotetikusht që ka pasur kursime *cash* ndër vite, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.400.000 lekë.

55.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për gjendjen *cash* si trung familjar në shumën 1.400.000 lekë.

55.5. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* si trung familjar në shumën 1.400.000 lekë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

56. Në lidhje me huat e dhëna nga babai i subjektit në vitin 2015

56.1. Konstatimi i ILDKPKI-së

- *mungesë burimi të ligjshëm financiar për huadhënien në vlerën 4.500.000 lekë në vitin 2015 nga shtetasi P.M (babai i subjektit);*
- *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga shtetasi P. M nga aktiviteti privat si avokat dhe noter;*
- *mungesë burimi të ligjshëm financiar për huadhënien në vlerën 1.500.000 lekë në vitin 2015 nga shtetasi P.M;*
- *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga shtetasi P.M nga aktiviteti privat si avokat dhe noter.*

Hetimi⁵⁰/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

57. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se në datën 31.12.2015 babai i tij i ka dhënë hua⁵¹ shumën prej 4.500.000 lekësh shtetasit Sh.Ll, klient dhe mik i tij, me burim të ardhurat e punës së tij si avokat dhe noter. Paratë janë kaluar me bankë dhe janë pasqyruar në kontratën noteriale me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 31.12.2015.

57.1. Në datën 31.12.2015, me kontratën e huas nr. ****, babai i subjektit i ka dhënë hua shtetasit Sh.Ll shumën 4.500.000 lekë. Në këtë kontratë parashikohet se në datën 14.8.2015 babai i subjektit i ka dhënë hua këtij shtetasi shumën prej 3.000.000 lekësh nëpërmjet llogarisë së tij në BKT dhe në datën 14.10.2015 i është dhënë hua shuma prej 1.500.000 lekësh, *cash*. Afati i kthimit të huas ishte brenda datës 29.12.2016. Në kontratë parashikohej se huaja mund të kthehet në monedhën lekë ose në monedhë të huaj (USD ose euro), ose me *klering* me objekt ndërtimi (truall + ndërtim), në vlerën e huas. Në DVP/2017 subjekti ka deklaruar se është kthyer shuma 150.000 lekë.

57.2. Nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit ka depozituar në datën 14.8.2015 shumën 3.000.000 lekë në BKT, shumë të cilën në të njëjtën datë ia ka dërguar shtetasit Sh.Ll, me emërtim “parapagim (kapar) për blerje shtëpie karabina”.

57.3. Komisioni ka administruar dokumentacionin bankar⁵² të veprimit të mësipërm, nga ku rezulton se babai i subjektit, në kërkesën për transaksion datë 14.8.2015, te seksioni “detajet e pagesës” ka shkruar *parapagim për blerje shtëpie karabina*.

57.4. Për sa më sipër, rezulton se ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, babai i tij i ka transferuar shumën 3.000.000 lekë shtetasit Sh.Ll për blerje shtëpie karabina. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 9.12.2020, ka sqaruar se *babai i tij ka ndërruar jetë dhe nuk ka si të gjejë arsyet e këtij emërtimi, por ndërkohë, sipas deklaratimit të z. Sh. Ll emërtimi parapagim për blerje shtëpie karabina është bërë për arsye se qëllimi i marrjes së huas nga ai tek babai i subjektit ka qenë për të blerë një shtëpi karabina*. Subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni nëse është blerë apo jo banesë nga huamarrësi.

⁵⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

⁵¹ Subjekti ka depozituar dokumentin kontratë huaje nr. **** rep., nr. *** kol., datë 31.12.2015

⁵² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.12.2020, të BKT-së.

57.5. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. ****, datë 14.12.2020, të z. Sh. Ll, i cili ka deklaruar se *shuma 3.000.000 lekë i është dhënë hua nga z. P.M, pasi nga ana e tij do të blihej karabinaja e një ndërtese për banim dhe deklaroi se blerja e ndërtesës karabina nuk u realizua dhe shuma 3.000.000 lekë vazhdon të jetë hua dhe do t'i shlyhet z. P.M gradualisht.*

57.6. Në lidhje me shlyerjen e shumës 4.500.000 lekë, rezulton se:

- në datën 10.11.2017 shtetasi Sh.Ll ka transferuar shumën 150.000 lekë, me emërtim “kthim detyrimi sipas kontratës së huas në llogarinë e babait të subjektit”;
- në datën 20.2.2018 shtetasi Sh. Ll ka transferuar shumën 350.000 lekë në llogarinë e babait të subjektit në BKT, me emërtim “kthim detyrimi sipas kontratës së huas”.

57.7. Si burim për dhënien e kësaj huaje subjekti ka deklaruar shumën 45.000 euro të kthyer nga motrat babait të tij, por që sipas tij nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore si gjendje *cash*, por është deklaruar në procesverbalin e datës 25.3.2009 në ILDKPKI.

57.8. Komisioni konstaton se ndryshe nga sa pretendon subjekti, në procesverbalin e datës 23.3.2016 në ILDKPKI është deklaruar se kursimet *cash* deri në datën 31.12.2014 kanë qenë në shumën 800.000 lekë. Në këto kushte, kur nuk provohet dhënia dhe kthimi i huas 45.000 euro, kjo shumë nuk do të mund të përfshihet në analizën financiare.

57.9. Gjatë vitit 2015 babai i subjektit, z. P.M⁵³, i ka dhënë hua shtetasit Xh.K (nipi i tij/djali i motrës) shumën prej 1.500.000 lekësh për blerje apartamenti. Shuma është dhënë *cash* në mirëbesim për shkak të marrëdhënieve familjare dhe është pasqyruar në deklaratën noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 23.1.2017. Nga dokumentacioni rezulton se:

- i. bazuar në deklaratën noteriale nr. ****, datë 23.1.2017, shtetasi Xh. K deklaroi se i ka marrë babait të subjektit shumën prej 1.500.000 lekësh për blerjen e një apartamenti në Elbasan, likuidimi i së cilës do të bëhej për një afat prej 3 vitesh;
- ii. në DVP/2017 subjekti deklaroi se është kthyer shuma prej 500.000 lekësh, kthimi i së cilës vërtetohet edhe nga nxjerrja e llogarisë bankare të babait të subjektit në BKT, nga ku rezultoi se në datën 14.11.2017 shtetasi Xh.K ka depozituar shumën 500.000 lekë;
- iii. në lidhje me burimin e huas, subjekti sërish ka deklaruar huan e pretenduar të kthyer nga motrat, e cila nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni në analizë financiare.

58. Në lidhje me huat e dhëna nga babai motrave të subjektit, në shumën totale 45.000 euro, rezultoi se:

- i. në DVP/2008 subjekti deklaroi se i është dhënë hua nga babai i tij:
 - a. motrës M. L, në shumë 20.000 euro; dhe
 - b. motrës A. Ç, në shumë 25.000 euro.

Si burim për të dy huat deklarohen të ardhurat e babait si noter.

- ii. në DPV-të e viteve 2008⁵⁴ dhe 2009⁵⁵ subjekti vijon të deklarojë këto hua në seksionin “të dhëna konfidenciale”;
- iii. në lidhje me këto hua subjekti, në procesverbalin e datës 25.3.2009, në ILDKPKI⁵⁶, ka sqaruar se shuma 45.000 euro e ka burimin nga të ardhurat e babait si noter për periudhën 1994 – 2006 dhe si avokat në vazhdim. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë zotërohet nga babai i tij;

⁵³ Subjekti ka depozituar dokumentin deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017

⁵⁴ Plotësuar me shkrim dore në datën 20.3.2009

⁵⁵ Plotësuar me shkrim dore në datën 15.3.2010

⁵⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së.

iv. në lidhje me kthimin e huave, subjekti, në procesverbalin e datës 23.3.2016, në ILDKPKI⁵⁷, ka deklaruar se huat janë kthyer pjesë-pjesë nga motrat në vite.

v. Gjatë hetimit subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 1.6.2020, ka shpjeguar se:

“Këto shuma i janë dhënë:

- motrës së vogël A. Ç, shuma 25.000 euro në vitin 2000 dhe janë kthyer prej saj në fund të vitit 2008;
- motrës së madhe M.L, shuma 20.000 euro në vitin 2002 dhe janë kthyer në fillim të vitit 2009.”

Të dyja këto hua i ka deklaruar në deklarinimin fillestar pas marrjes së detyrës në vitin 2008. Në procesverbalin e datës 25.3.2009, kur është pyetur në ILDKPKI ka deklaruar tekstualisht: *Kjo shumë zotërohet nga ana e babait të tij P. M, çka do të thotë që është deklaruar si gjendje cash. Duke qenë se u pyeta përpara ILDKPKI-së dhe ky procesverbal bëhej pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, nuk e përmenda në deklarinimin e vitit 2009 për shkak mospërsëritjeje”.*

58.1. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit rezulton se DPV/2008 është plotësuar në datën 20.3.2009, pra 5 ditë para deklarimeve të tij në ILDKPKI. Gjithashtu, rezulton se në procesverbalin e datës 25.3.2009 subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e babait për vitet 1994 – 2006 dhe nga viti 2006 e në vazhdim nga puna si avokat. Pra, bazuar në deklarinimet e subjektit rezulton se këto hua nuk mund të jenë dhënë në vitet 2000 dhe 2002.

vi. Komisioni ka hetuar në lidhje me mundësinë e motrave të subjektit për të kthyer huat dhe nga hetimi ka rezultuar se:

QKB-ja⁵⁸informon se:

Shtetasi L. L figuron:

- Të ketë qenë administrator dhe është ortak me 100 % të kuotave në shoqërinë “K ***” sh.p.k., me NIPT L****Q, regjistruar në datën 27.8.2012, aktualisht me status “pezulluar”. Bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël⁵⁹ të viteve 2012 - 2015 rezulton:

Tabela nr. 11

Viti	Fitim/humbje, lekë	Fitimi pas tatimit, lekë
2012	-44,578	
2013	270,620	
2014	245,000	220,000
2015	-52,100	

- Person fizik me NIPT K*****M, regjistruar në datën 9.10.2008. Aktualisht me status “çregjistruar”. Bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël⁶⁰ të viteve 2009 – 2014, fitimi i deklaruar është 0 (zero).

⁵⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së.

⁵⁸ Shkresë nr. **** prot., datë 6.1.2021

⁵⁹ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së.

⁶⁰ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së.

- Person fizik me vendimin nr. ***, datë 22.10.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Administrator i shoqërisë “K” sh.p.k., me NIPT J****B, regjistruar në datën 20.3.1998.
- Ortak dhe administrator i shoqërisë “K/D” sh.p.k., me NIPT J*****K, regjistruar në datën 1.7.1996, aktualisht me status “çregjistruar”. Bazuar në deklaratat e tatim-fitimit për periudhën 2008 - 2013⁶¹ fitimi i deklaruar është 0 (zero).
- Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë e sigurimeve “A”, me NIPT K****V, regjistruar në datën 3.4.2000. Larguar më 21.6.2018

Bazuar në shkresën nr. ***** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së rezulton:

- Administrator i shoqërisë “EHW-K”, me NIPT K****R. Bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2013 - 2015 fitimi i deklaruar dhe xhiroja janë 0 (zero).
- Administrator i subjektit “E-D” (OJF), me NIPT L*****E, regjistruar më 5.7.2010

Shtetasja M. L figuron:

- Person fizik me NIPT L****K, regjistruar më 7.2.2019, aktualisht me status “pezulluar”.

Shtetasi A. Ç figuron:

- Person fizik me NIPT K*****I, regjistruar në datën 18.3.2003, ndërkohë në ekstraktin historik rezulton se është regjistruar më 21.1.1998, me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël⁶² fitimi rezulton si vijon:

Tabela nr. 12

Viti	Fitimi i deklaruar
2012	0
2013	1,800,000
2014	167,860
2015	350,846
2016	428,128
2017	444,542
2018	298,125
2019	591,998

- Person fizik regjistruar me vendim nr. ***, datë 30.1.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.
- Person fizik regjistruar me vendim nr. ***, datë 25.2.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁶¹ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së.

⁶² Shihni shkresën nr. **** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së.

58.2. Bazuar sa më sipër, rezulton se motrat e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas babait të tyre. Gjithashtu, edhe babai i subjektit, bazuar në analizën financiare deri në momentin e dhënies të huave, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e tyre.

58.3. Komisioni ka kryer një analizë financiare të vitit 2015 të subjektit dhe personave të lidhur me të, si vijon:

Tabela nr. 13

	Viti 2015
PASURI	7,658,197
Automjet "V. Sh"	1,536,390
Dhënë hua nga babai tek z. Sh.Ll	4,500,000
Dhënë borxh nga babai tek nipi Xh. K (gjatë vitit 2015)	1,500,000
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	<i>121,807</i>
Likuiditete gjendje	5,636,092
DETYRIME	0
Marrë hua babai nga M.SH.C.	
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	7,658,197
TË ARDHURA, dokumentuar	3,431,553
Të ardhura nga paga e subjektit	1,347,208
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	638,741
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	0
Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, babai	348,000
Pensioni i nënës	175,477
Pensioni i babait	191,080
Shpërblime për lindjen e fëmijëve (nga Bashkia)	10,000
Të ardhura nga shitja e pasurive	686,400
Të ardhura nga interesat bankare	34,646
SHPENZIME	1,593,928
Shpenzime jetese	1,420,415
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	62,386
Paguar karta e kreditit	11,127
Blerje mallrash/pajisje elektroshtëpiake	100,000
Mundësia për kursime	-5,820,571

58.4. Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas shtetasve Sh. Ll. dhe Xh. K., në vlerën 5.820.571 lekë.

58.5. Në lidhje me huat e dhëna shtetasve Sh. Ll. dhe Xh. K., Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon:

- i. subjekti nuk ka deklaruar saktë kohën e dhënies dhe kthimit të huave në shumën totale 45.000 euro nga babai tek motrat e tij;
- ii. babai i subjektit në asnjë prej deklaratave periodike vjetore nuk ka deklaruar kthimin e këtyre huave;
- iii. subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat e ligjshme për kthimin e huave nga motrat e tij;
- iv. babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e këtyre huave.

Për rrjedhojë, shuma 45.000 euro nuk do të përfshihet në analizë financiare të vitit 2015.

- v. nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas z. Sh. Ll.;
- vi. babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huas 1.500.000 lekë;
- vii. Komisioni vlerëson të theksojë se subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin e datës 23.3.2016, përpara ILDKPKI-së, deklaroi se në datën 31.12.2014 ka gjendje *cash* në shumën 800.000 lekë, për rrjedhojë, të gjitha deklaratimet e subjektit në lidhje me mosdeklarimet e gjendjes *cash* ndër vite nuk përputhen me deklaratimet në ILDKPKI, ku ai ka deklaruar se ka gjendje *cash* shumën 800.000 lekë.

58.6. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se që prej deklarimit për herë të parë pas emërimit me detyrë si prokuror i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, dhe në vazhdim, ka deklaruar DPV-të vjetore vetëm ai si subjekt dhe bashkëshortja e tij, në kuptim të pikës 5 të nenit 7 “deklarimi periodik vjetor” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ku përcaktohet se *mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/esja dhe fëmijët madhorë*. Deklarimet më vete nuk janë bërë nga babai dhe nëna e tij, pasi në formularin e deklarimit deklaroheshin vetëm të ardhurat e bashkëshortes ose të fëmijëve dhe nuk kanë pasur detyrimin të deklaroheshin vetë ata. Ai ka deklaruar të ardhurat nga biznesi dhe shtimin e pasurisë nga babai me qëllim pasqyrimin e të gjithë transaksioneve të familjes.

58.7. Në asnjë deklaratë, si para fillimit të detyrës, ashtu edhe në ato periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* që disponohej nga babai i tij. Gjendja *cash* është mbajtur nga vetë ai për të ardhurat e realizuara. Subjekti nuk e ka ditur sa kanë qenë kursimet e babait dhe shtesat që ai ka pasur çdo vit. Por fakti se në vitin 2015 ka dhënë hua shumën 6.000.000 lekë, ka depozituar në bankë në janar të vitit 2017 shumën 2.700.000 lekë dhe ka pasur gjendje *cash* të trungut familjar shumën 1.400.000 lekë, deklaruar në deklaratën “Vetting”, tregon se kursimet e tij në vite kanë qenë të konsiderueshme. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 25.3.2016, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* e disponuar prej tij dhe bashkëshortes në datën 31.12.2014, ka qenë në shumën 800.000 lekë. Në deklaratën “Vetting”, në kuptim dhe respektim të detyrimit ligjor të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* që disponohej prej gjithë pjesëtarëve të familjes, përfshirë edhe prindërit e tij. Deklarimin si person i lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, neni 30 “objekti i vlerësimit të pasurisë” dhe neni 32/1 e kanë bërë edhe prindërit e subjektit, P dhe M .M. Deklarimet e tij për gjendjen *cash* nuk duhet të shërbejnë si provë nga Komisioni për gjendjen *cash* të babait të tij. Subjekti shprehet se *Komisioni duhet të përfshijë gjendjen cash të kthyer nga huat e dhëna motrave, në shumën 45.000 euro. Nuk mund të shprehet për shtesat gjatë viteve 2009 e në vazhdim, por i kërkon Komisionit që tepricat e viteve që rezultojnë dhe vijnë si rezultat i diferencës ndërmjet të ardhurave të realizuara nga babai i tij me shpenzimet dhe pasuritë e shtuara të konsiderohen si mundësi kursimi.*

58.8. Në lidhje me hetimin e Komisionit mbi mundësinë e kthimit së huave nga motrat, subjekti sqaron se shtetasi L.L ka qenë administrator dhe ortak shoqërisë “K/D” sh.p.k., me NIPT J****K. Gjithashtu, ka qenë i regjistruar edhe si person fizik me NIPT K*****M, me objekt aktiviteti “Studim, projektim e zbatim të punimeve në pyje e kullota. Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis dhe monitorimin mjedisor, etj.” Bazuar në shkresën nr. **** prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, rezulton se për vitin 2008 ka paguar 30.750 lekë taksë e biznesit të vogël vetëm për 3 muaj regjistrim. Qarkullimi i deklaruar ka qenë i lartë dhe detyrimi për taksat vendore gjithashtu. Për vitin 2009 ka paguar 33.750 lekë taksë biznesi të vogël. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të personit juridik, në cilësinë e administratorit të shoqërisë, ka përfituar edhe pagë. Nga *statement*-i bankar i llogarisë së shoqërisë “K” sh.p.k. në BKT, rezulton se janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe ka të dhëna të pagesave nga gushti i vitit 2006 deri në nëntor të vitit 2007.

58.9. Po kështu, për shtetasin L.L, me anë të vërtetimit për bazën e vlerësuar, konfirmuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, është konfirmuar paga *bruto* për periudhën janar 2007 – qershor 2007, ndërkohë që për muajin korrik dhe në vazhdim është bërë shënimi që nuk ka lista. Referuar *statement*-it bankar të BKT-së konfirmohen pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe për muajt që nuk ka lista. Shtetasi L.L, në cilësinë e administratorit të shoqërisë, ka paguar minimum për vete këto kontribute, referuar edhe praktikës ligjore. Edhe pse ISSH-ja nuk konfirmon listëpagesat, *statement*-i bankar konfirmon pagesat në favor të këtij institucioni. Shtetasi A. Ç është i regjistruar si person fizik me NIPT K****I, që prej datës 18.3.2003. Duke qenë subjekt i biznesit të vogël, qarkullimi dhe taksa që prej vitit 2006 deri në vitin 2009 janë deklaruar në Bashki. Drejtorja e Tatim-Taksave në Bashkinë Krujë, sipas përgjigjes së dhënë në datën 29.3.2021, vërteton se subjekti “A.Ç”, person fizik, me NIPT K*****I, nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara deri në vitin 2020.

59. Komisioni analizoi shpjegimet e subjektit, si vijon:

59.1. Në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes cash të babai ndër vite

59.1.1 Nga verifikimi i deklaratës para fillimit të detyrës dhe deklaratave periodike vjetore, rezulton se subjekti ka deklaruar rregullisht:

- i. Të ardhurat e babait dhe nënës së tij.
- ii. Dhënien e huave⁶³ në shumat 25.000 euro dhe 20.000 euro, dhënë nga babai motrave të subjektit.
Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar si gjendje *cash* shumën e kthyer babait nga motrat, si dhe nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratat periodike vjetore kthimin e këtyre huave, sikundër ka deklaruar dhënien e tyre. Deklarimet e bëra në ILDKPKI janë kontradiktore, pasi subjekti:
 - ka deklaruar në procesverbalin e datës 25.3.2009, në ILDKPKI, se kjo shumë zotërohet nga babait të tij dhe ka si burim të ardhurat nga puna e të atit deri në vitin 2006, ndërkohë që ka deklaruar se huat janë dhënë në vitet 2000 dhe 2002;
 - ka deklaruar në procesverbalin e datës 23.3.2016 në ILDKPKI se huat janë kthyer pjesë-pjesë nga motrat në vite, por pa deklaruar një kohë të saktë të kthimit të tyre.
- iii. Llogarinë e kursimit të hapura në vitin 2012 në BKT nga nëna e tij, deklaruar rregullisht në çdo DVP, nga viti 2012.

⁶³ Deklaruar në DVP/2008-2009.

- iv. Të ardhurat e babait janë deklaruar si burim për blerjen e automjetit tip “M-B. C. A” në DVP/2014 në pronësi të bashkëshortes së subjektit.
- v. Blerja e garazhit nga babai i tij është deklaruar në DVP/2016, ku si burim deklarohet kursime familjare dhe jo kursime të babait të tij.

59.1.2. Në nenin 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, parashikohet se: *“Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur”.*

59.1.3. Nëse i referohemi nenit të mësipërm, prindërit e subjektit nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë e tyre, por ndërkohë ata i kanë deklaruar rregullisht ato, sikundër rezultojnë më lart.

59.1.4. Subjekti ka deklaruar se ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit e tij, pasi ka jetuar me ta dhe ka ndarë shpenzimet e jetesës. Nga ana e subjektit, në asnjë rast nuk është pretenduar se ai ka pasur ekonomi të ndarë nga prindërit e tij. Komisioni e ka kryer analizën financiare duke përfshirë edhe të ardhurat e prindërve të subjektit, pasi në rastin kur këto të ardhura nuk do të përfshiheshin do të kishim rezultat negativ në disa vite për familjen e tij.

59.1.5. Në përfundim, Komisioni, duke analizuar deklaratimet periodike të subjektit ndër vite, të cilat përbëjnë provë, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se kursimet *cash* të babait, të pretenduara nga subjekti, nuk do të përfshihen në analizën financiare, duke u bazuar dhe duke pasur parasysh se:

- i. subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës çdo interes pasuror të prindërve të tij dhe në logjikën e deklarimeve nuk kishte si të mos deklaroheshin kursimet *cash* të babait nëse ky i fundit do t’i kishte këto kursime deri para fillimit të detyrës;
- ii. subjekti, në vijimësi, ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore të ardhurat e prindërve të tij dhe krijimin e pasurive të tjera;
- iii. subjekti ka deklaruar se ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit;
- iv. subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të sqaruar kursimet *cash* të babait në deklaratën “Vetting” – ai nuk rezultojnë të ketë deklaruar që babai i tij ka pasur kursime *cash* ndër vite, si dhe të ketë deklaruar faktin që huat e dhëna shtetasve Sh. Ll. dhe Xh.K e kanë burimin nga huat e kthyer nga të motrat, të cilat babai i kishte pasur në banesë si kursime *cash*;
- v. shumën e konsiderueshme *cash* të pretenduar të mbajtur nga babai në të njëjtën banesë që jetonte edhe subjekti, e cila është më shumë se 10.000.000 lekë, nëse i referohemi pretendimeve të subjektit në barrën e provës;
- vi. subjekti, në deklaratën “Vetting”, kur i referohet burimit të pasurive, deklarohet kursime familjare dhe jo kursime *cash* të babait;
- vii. subjekti në pretendimet e tij nuk jep një vlerë të saktë për kursimet *cash* të babait;
- viii. nëse do të llogaritej mundësia për kursim e babait të subjektit duke e ndarë më vete nga subjekti si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet apo kursimet, gjithësesi do të rezultojnë me një bilanc negativ në disa vite pikërisht për vet subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ky i fundit ndër vite ka deklaruar si burime financiare për shpenzimet e kryera prej tij të ardhurat e babait të vet.

- ix. Gjithsesi llogaritja e kursimeve cash për babain e subjektit është e pamundur të realizohet veçmas, pasi nuk mund të abstragohet mundësia e tij autonome për kursime, për sa kohë ai ka jetuar së bashku me subjektin dhe shpenzimet e tyre kanë qenë të përbashkëta – sikurse është deklaruar dhe pranuar edhe nga vetë subjekti.

59.2. Në lidhje me huat e pretenduara, të kthyera nga motrat e subjektit

59.2.1. Subjekti, në lidhje me të ardhurat e shtetasve M.L dhe L.L, ka depozituar:

- i. shkresë nr. **** prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, në të cilën deklarohet se subjekti “K/D” sh.p.k., me administrator z.L.L, me NIPT J*****K, për periudhën 2000 – 2010, nga të dhënat e sistemit c@ts rezulton se nuk ka detyrime tatimore dhe gjithashtu nuk gjenden të dhëna të tjera, pasi dokumentacioni për periudhën në fjalë është i dëmtuar;

Në lidhje me këtë shkresë konstatohet se DRT-ja Dibër sërish deklaron se për periudhën 2000 – 2010 mungojnë të dhëna, por ky konstatim nuk përputhet me të dhënat e hetimit, nga ku rezulton se bazuar në deklaratat e tatim-fitimit për periudhën 2008 – 2013⁶⁴ fitimi i deklaruar është 0 (zero).

- ii. shkresë nr. ***** prot., datë 24.3.2021, të Bashkisë Tiranë, sipas së cilës deklarohet se z. L.L ka likuiduar detyrimet për periudhën 9.10.2008 – 31.12.2010, si vijon:

- viti 2008 – shuma totale 36.225 lekë, nga të cilat 30.750 lekë taksë biznesi e vogël, 500 lekë taksë ndërtese për sip. 10 m², 375 lekë taksa e tabelës, 2.500 lekë tarifa e pastrimit dhe 2.000 lekë taksë e gjelbër;
- viti 2009 – vlera totale 56.050 lekë, nga të cilat 33.750 lekë taksë e biznesit të vogël, 1.800 lekë taksë ndërtese për sip. 10 m², 1.500 lekë taksa e tabelës, 9.000 lekë tarifa e pastrimit dhe 10.000 lekë taksë e gjelbër;
- viti 2010 – 120 lekë taksë tabele;

Me këtë shkresë nuk vërtetohet se ka qenë xhiroja e deklaruar apo se për cilin NIPT bëhet fjalë.

- iii. llogari të shoqërisë “K” sh.p.k. në USD dhe në lekë në “I. S.B”;

- iv. llogari të shoqërisë “K” sh.p.k. në lekë në BKT;

- v. vërtetimi mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nr. **** prot., datë 15.6.2020, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë;

- vi. vërtetim për bazën e vlerësuar të degës së ISSH-së Dibër për periudhën 2004 – 2007.

59.2.2. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm, por dhe të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes së motrës së tij, M.L, për kthimin e huas në shumën 20.000 euro. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se, edhe sikur të ishte provuar mënyra dhe koha e kthimit të kësaj shume, kjo nuk mund të konsiderohej si një burim i ligjshëm në disponim të subjektit dhe familjes së tij, për sa kohë ajo nuk është deklaruar si e ardhur në vitin përkatës dhe nuk plotësohet kushti i burimit të ligjshëm, në kuptim të nenit D pika 1,3,5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe për pasojë gjendemi në aplikim të nenit 33/5, shkronja b, të Ligjit 84/2016.

59.2.3. Subjekti, në lidhje me të ardhurat e shtetasve A. Ç dhe A.Ç, ka depozituar:

- a. certifikatë regjistrimi në organin tatimor të vitit 2005, të z. A.Ç, me objekt “prodhim tregtim artikuj prej druri”;

⁶⁴ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 23.12.2020, të DPT-së.

- b. deklaratë datë 17.3.2005, mbi xhiron e realizuar për vitin 2004, ku z. A.Ç deklaroi xhiro 1.400.000 lekë, ndërsa xhiron e deklaruar për vitin 2005 është 1.400.000 lekë;
- c. tabelë llogaritjeje e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin e biznesit të vogël për vitin 2006 – tatimi 30.000 lekë për xhiro 2.000.000 lekë;
- d. formular deklarimi i qarkullimit të biznesit të vogël për periudhën tatimore 2006 – xhiro e deklaruar 1.400.000 lekë;
- e. njoftim detyrimi nr. *** prot., datë 25.5.2007, i Bashkisë Fushë-Krujë – detyrimi total 86.100 lekë;
- f. mandatar-këtim nr. ****, datë 6.8.2007, paguar shuma 60.000 lekë nga z. A.Ç Bashkisë Fushë-Krujë;
- g. akt-detyrim nr. *** prot., datë 28.3.2008, i Bashkisë Fushë-Krujë, për taksat dhe tarifatat vendore – shuma e detyrimit 42.700 lekë;
- h. mandatar-këtim nr. ****, datë 2.12.2008, paguar shuma 42.700 lekë nga z. A.Ç Bashkisë Fushë-Krujë;
- i. tabelë llogaritjeje e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin e biznesit të vogël për vitin 2003 – tatimi 52.000 lekë për xhiro 1.300.000 lekë;
- j. urdhër-pagesë datë 20.4.2007, pagesë tatimi i thjeshtuar mbi fitimin 1.999.685 lekë dhe 2.000 në vlerën 18.451 lekë;
- k. urdhër-pagesë datë 19.9.2003, pagesë tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në vlerën 26.000 lekë;
- l. urdhër-derdhje datë 30.3.2004, për taksën vendore në shumën 36.000 lekë;
- m. urdhër-derdhje datë 22.9.2003 (nuk lexohet mirë), për tatimin për vitin 2003 në shumën 34.600 lekë;
- n. urdhër-derdhje datë 18.10.2004, paguar taksa vendore në shumën 28.000 lekë;
- o. pagesë datë 20.4.2007, në shumën 19.136 lekë, paguar tatimi i thjeshtuar për vitet 1999 dhe 2000;
- p. vërtetim i degës së tatim-taksave nr. *** prot., datë 20.4.2007, ku vërtetohet se z. A.Ç nuk ka detyrime të palikuiduara tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore pranë degës së tatim-taksave Krujë;
- q. urdhër-derdhje datë 17.3.2005, për pagesën e taksës vendore në shumën 121.350 lekë.

59.2.4. Nga një llogaritjeje e fitimit bazuar në xhiron e deklaruar nga z. A.Ç, rezulton me një fitim prej 3.100.000 lekësh.

59.2.5. Në lidhje me këtë hua rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion të mjaftueshëm për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes së motrës së tij, A.Ç, për kthimin e huas në shumën 25.000 euro, por nëse do të përfshiheshin shpenzimet jetike atëherë sërish subjekti do të ishte në pamundësi për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të së motrës për kthimin e huas në shumën 25.000 euro.

59.2.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma 45.000 euro nuk do të përfshihet në analizën financiare, pasi subjekti:

- i. nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave për kthimin e huas nga ana e motrave të tij;
- ii. nuk rezulton të ketë deklaruar kthimin e këtyre huave në vitin 2009;
- iii. nuk rezulton të ketë deklaruar si gjendje *cash* të babait për vitet 2009 - 2015 shumën 45.000 euro; si dhe
- iv. nuk rezulton që në deklaratën “Vetting” të ketë deklaruar faktin që kthimi i këtyre huave ka shërbyer si burim për dhënien e huave në vitin 2015.

59.2.7. Në konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huave shtetasve Sh. Ll. dhe

Xh.K, në shumën totale 6.000.000 lekë. Si rrjedhojë, babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme për dhënien e këtyre huave në vitin 2015, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT, ZNJ. E.M – DEKLARIMI I PASURIVE

60. Automjet tip “M-B A *”⁶⁵**, prodhim i vitit 2001, blerë në vlerën 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

60.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: blerë nga vjehri, z. P. M, nga të ardhurat e tij.

Hetimi⁶⁶/analiza ligjore-financiare i/e kryer i nga Komisioni

61. Në datën 22.9.2014, me anë të kontratës së shitblerjes me nr. ****, bashkëshortja e subjektit ka blerë automjetin tip “D.C”⁶⁷ në vlerën 200.000 lekë. Ky automjet është shitur në datën 16.5.2018, me kontratën nr. ****, për shumën 150.000 lekë. Nga analiza financiare rezulton se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Tabela nr. 14

	Datë 22.9.2014
PASURI	740,847
“M.D C”, E	200,000.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	540,847.21
Likuiditete gjendje	5,176,109.85
TË ARDHURA, dokumentuar	1,925,845.17
Të ardhura nga paga e subjektit	876,980.25
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	233,955.75
Të ardhurat nga aktivitetet private të babait	300,000.00
Pensioni i nënës	172,712.08
Pensioni i babait	188,297.08
Të ardhura nga interesat bankare	153,900
SHPENZIME	1,164,703
Shpenzime jetese	879,992
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	105,297
Paguar karta e kreditit	119,415
Blerje mallrash/pajisje elektroshtëpiake	60,000
Mundësia për kursime	20,294.48

⁶⁵ Subjekti ka dorëzuar dokumentin kontratë shitblerjeje me nr. ***rep., nr. **** kol., datë 22.9.2014

⁶⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 18.12.2019, e DPSHTRR-së.

⁶⁷ Deklaruar në DVP/2014.

Nuk kanë rezultuar paqartësi apo mungesë burimesh financiare në lidhje me këtë pasuri.

61.1. Në datën 22.3.2018, me faturën nr. ***, bashkëshortja e subjektit ka blerë automjetin tip “T.A”, në shumën 590.000 lekë.

Tabela nr. 15

	Datë 22.3.2018
PASURI	-412,458
Automjet “T.A” AA *** TM, E	590,000.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	-1,002,457.53
Likuiditete gjendje	8,359,850.88
TË ARDHURA, dokumentuar	397,133.25
Të ardhura nga paga e subjektit	60,300.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	88,750.00
Të ardhura nga prindërit	248,083.25
SHPENZIME	430,982
Shpenzime jetese	430,982
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	
Mundësia për kursime	378,608.35

61.2. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie dhe nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë.

62. Llogari bankare (ish-llogari page) në BKT⁶⁸, me nr. IBAN AL*****W, e hapur nga universiteti “E”. Kjo llogari nuk shërben më si llogari page, pasi universiteti ka ndërruar bankë duke bërë depozitimim e pagës në “I.S.B”. Gjendja e mbetur në llogari: 348,25 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi⁶⁹/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

62.1. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në BKT, gjendja në datën 27.1.2017 është 198,25 lekë.

62.2. Në datën 7.7.2015 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë. Burimi i kësaj shume janë pagat e saj të patërhequra, për periudhën 11.1.2012 deri në datën e tërheqjes së kësaj shume. Në lidhje me këtë shumë subjekti⁷⁰ ka sqaruar se ajo është tërhequr për pagesën e studimeve të doktoraturës së bashkëshortes. Pagesa nuk u krye, pasi nuk u hapën kuotat dhe, për rrjedhojë, u ridepozituar në llogari.

Subjekti ka qenë i saktë në deklaram.

⁶⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, të BKT-së për znj. E.M.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

⁷⁰ Shihni pyetësorin datë 9.12.2020

63. Llogari bankare në “I. S. B”, me nr. ****, e hapur nga universiteti “E”⁷¹, në datën 1.11.2016. Gjendja e mbetur në llogari: 676 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi⁷²/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

64. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në datën 26.1.2017, në “I. S. B”, gjendja e llogarisë më 23.1.2017 është 676 lekë.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

65. Llogari bankare në “C. B” – shuma e depozituar ka qenë rreth 1.100.000 lekë.

65.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: dhënë nga nëna dhe babai si dhuratë në vitin 2010 për të ndjekur studimet pasuniversitare jashtë shtetit. Duke qenë se kjo gjë nuk u realizua, kjo llogari pas martesës është mbyllur dhe në datën 21.9.2012 ka kaluar në emër të nënës së bashkëshortes, znj. V. D, po në “C.B”, me nr. *****.

Hetimi⁷³/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

66. Në DVP/2011 subjekti ka deklaruar se kjo llogari është dhuratë nga nëna e bashkëshortes në vitin 2010.

66.1. Bazuar në shkresën nr. * prot., datë 26.12.2019, të “C. B”,** rezulton se bashkëshortja e subjektit ka depozituar në datën 25.9.2010 shumën 1.011.600 lekë. Kjo shumë, së bashku me interesat e përfituara (shuma totale 1.140.328 lekë) në datën 26.9.2012, i është transferuar znj.V. F.D.

Nuk ka dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë deklaram.

67. Llogari bankare në vlerën 1.000.000 lekë në BKT

67.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura të dhëna nga familja, babai dhe nëna, para martese, si dhe para të grumbulluara si dhuratë për lindjen e tre fëmijëve. Shuma prej 800.000 lekësh është deklaruar që në vitin 2011. Këto para janë derdhur në një llogari të përbashkët me bashkëshortin Bledar Maksuti në BKT, me nr. IBAN AL*****D. *Statement*-i datë 14.1.2017, i BKT-së, bashkëlidhur edhe fatura e derdhjes së parave në llogarinë bankare.

67.2. Konstatim i ILDKPKI-së:

- *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të prindërve të bashkëshortes për shumën totale 1.900.000 lekë në vitin 2011.*

Trajtuar në pikën 46 të këtij vendimi.

DEKLARIMI I BABAIT TË SUBJEKTIT, Z. P.M – DEKLARIMI I PASURIVE

68. Truall⁷⁴ i marrë në pronësi nga babai i subjektit në datën 12.5.1997, në Peshkopi, mbi të cilin është ndërtuar një lokal me sip. 80 m², që ka kushtuar 500.000 lekë. Ky truall, së bashku me lokalin, i është shitur në datën 15.2.1999, në vlerën 1.500.000 lekë, shtetasit V.Sh. Vërtetim

⁷¹ Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, të “I. S.B”, për znj. E.M.

⁷² Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 13.12.2019, të “I. S.B”.

⁷³ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 26.12.2019, të “C. B”.

⁷⁴ Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) akt noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.1999, për kalimin në pronësi truall + lokal; dhe (ii) vërtetim pronësie nr. *** regj., datë 12.5.1997, për lokal me sip. 80 m².

hipotekor nr. ***, datë 12.5.1997, dhe kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 15.2.1999.

68.1. Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *deklarim i pasaktë në lidhje me vlerën e lokalit në lagjen “Gj. D”, Dibër, në emër të shtetasit P. M (babai) 500.000 lekë, pasi referuar situacionit bashkëlidhur përgjigjes së ZVRPP-së Dibër, vlera e objektit është 1.108.065 lekë.*

Hetimi⁷⁵/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

69. Në datën 15.2.1999, subjekti, së bashku me familjarët e tij, me anë të aktit noterial nr. ***, për kalimin në pronësi truall + lokal, kanë shitur truall me sip. 230 m² dhe lokal me sip. 80 m², për shumën 1.500.000 lekë. Lokali ka nr. pasurie ****-ND, z. k. **. Tatimi mbi të ardhurat është paguar nga blerësi me mandatar këtëim nr. ***, datë 2.3.1999, në shumën 7.500 lekë.

69.1. Vlera e lokalit, bazuar në vërtetimin e pronësisë me nr. ***, datë 12.5.1997⁷⁶, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën “Vetting” në ILDKPKI, rezulton në shumën 1.108.065 lekë (në vërtetim kjo vlerë deklarohet me çmim të liberalizuar të specialistit të fushës).

69.2. Nga hetimi në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar se:

- me aktin noterial nr. ****, për kalimin në pronësi truall, babai i subjektit ka blerë në datën 12.2.1999, truall⁷⁷ me sip. 230 m², për shumën 350.000 lekë.
Blerja e truallit nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting”.
- me vendim nr. ***, datë 17.4.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është vendosur vërtetimi i faktit juridik të qenies së subjektit dhe familjarëve të tij bashkëpronarë të një lokali, i cili, i vlerësuar me çmim të liberalizuar, ka vlerën 1.108.065 lekë.
- bazuar në situacionin e objektit të tetorit të vitit 1996, bashkëlidhur lejes së ndërtimit, vlera e ndërtimit është 1.108.065 lekë.
- në vendimin e gjykatës deklarohet se subjekti ka dhënë kontributin e tij në ndërtimin e lokalit.

Vlera e ndërtimit në shumën 1.108.065 lekë nuk rezulton e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Vendimi nr. ***, datë 17.4.1997, nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën e tij takuese në këtë lokal.

69.3. Në lidhje me konstatimet e mësipërme, subjekti ka sqaruar⁷⁸ se *lokali është deklaruar në deklaratën “Vetting” në pjesën që i takon babait, pasi çdo gjë është bërë nga ai dhe kjo ka qenë arsyeja që e ka deklaruar si pasuri të tij. Është deklaruar vetëm shitja e lokalit, pasi në kohën e përpilimit të deklaratës “Vetting” disponohej vetëm kontrata e shitjes, por nuk ka pasur arsye për fshehje të vlerës së truallit, situacionit të ndërtimit dhe akteve të tjera. Vendimi i gjykatës është i vitit 1997, kur ai ka qenë 20 vjeç dhe student në Tiranë. Si blerja e truallit të tokës, ashtu edhe shitja e lokalit, kanë ndodhur nga viti 1996 – 1999, kohë në të cilën ka qenë student. Deklarata “Vetting” në kuptimin e tij ka qenë për pasuritë e krijuara nga momenti i marrjes së detyrës. Krijimi dhe më pas tjetërsimi (shitja e kësaj pasurie) ka ndodhur gjatë*

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.12.2019, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Dibër.

⁷⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së.

⁷⁷ Nr. pasurie ****, z. k. ****

⁷⁸ Shihni pyetësin datë 9.12.2020

kohës që ka qenë student, për këtë arsye ka deklaruar vetëm shitjen dhe jo detajet e tjera. Nuk është fshehur si pasuri, sa kohë që është deklaruar edhe me çmimin real të saj në shitje. S'ka pasur arsye për të fshehur vendimin e gjykatës që e bënte pronar. Arsyeja ka qenë se nuk është gjendur si dokument në atë moment dhe u gjend më vonë. Kontributi në krijimin e kësaj pasurie ka qenë vetëm në punë fizike, pasi nuk pasur të ardhura, duke qenë se ka qenë student.

69.4. Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë pasuri: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën tij takuese në lokal; (ii) subjekti nuk ka depozituar dokumentacion e plotë të përfitimit të kësaj pasurie; (iii) ka mospërputhje në lidhje me deklarimin e babait të subjektit për sa i përket vlerës së kësaj pasurie, pasi është deklaruar 500.000 lekë, ndërkohë që vlera e trullit është 350.000 dhe vlera e lokalit është 1.108.065 lekë; (iv) babai i subjektit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” vlerën e blerjes së trullit.

69.5. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me rezultatet e mësipërme të hetimit.

69.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se babai i subjekti/subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

69.7. Në datën 4.6.1993 ka privatizuar **apartament 2+1 në Peshkopi për shumën 16.525 lekë**, ndërtuar në vitin 1984. Ky apartament është shitur në datën 10.6.2004, për shumën 2.500.000 lekë (trajtuar në pikën 27.2.1 të këtij vendimi).

70. Në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit

70.1. Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Deklarim i rremë në lidhje me të ardhurat e shtetasit P M (babai i subjektit) nga aktiviteti privat avokat – noter, deklaruar në shumën 33.055.000 lekë, pasi nuk konfirmohen nga institucionet përkatëse.*

Hetimi⁷⁹/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

71. Në deklaratën “Vetting” babai i subjektit ka deklaruar:

“Të ardhura nga puna si avokat dhe noter për periudhën 1.1.1993 – 31.3.2016, në vlerën 33.055.000 lekë.

- *për periudhën 1.1.1993 – 31.3.1996, avokat me nr. license ***, datë 2.9.1992;*
- *për periudhën 1.4.1996 – 15.6.2006, noter dhe përsëri si avokat nga 1.1.2007 – 31.12.2016.*

Për vitet 1993 - 2000 i është kërkuar me shkresë Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, për të saktësuar të ardhurat, por nuk është kthyer përgjigje. Llogaritja e të ardhurave për periudhën 1.1.1993 - 31.3.1996 është bërë duke marrë për bazë të ardhurën faktike, si dhe tatimin fiks të kohës për të ardhurat. Për vitet e tjera mbi bazën e tatimeve të paguara. Në vitin 2016 jam përjashtuar nga tatimi për shkak të moshës”.

71.1. Subjekti, për të vërtetuar të ardhurat e babait, ka depozituar së bashku me deklaratën “Vetting” dokumentacionin e mëposhtëm:

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 24.12.2019, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Dibër.

➤ **Në lidhje me aktivitetin si avokat për vitet 1992 - 1996**

- licencë nr. ***, datë 27.8.1992, lëshuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë në datën 2.9.1992, nëpërmjet së cilës babait të subjektit i jepet e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit me qendër në Peshkopi;
- vendim nr. ****, datë 3.9.1992, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për regjistrimin si person juridik privat të babait të subjektit në fushën e avokatisë.

Subjekti pretendon se të ardhurat e babait të tij si avokat për periudhën 1.1.1993 – 31.3.1996 janë 3.120.000 lekë ose 80.000 lekë/muaj.

➤ **Në lidhje me aktivitetin si noter për vitet 1996 - 2006**

- i. urdhër nr. ***, datë 10.1.1996, i ministrit të Drejtësisë për emërimin si noter të babait të subjektit;
- ii. leje nr. ****, datë 10.1.1996, për ushtrimin e profesionit të noterit të babait të subjektit me qendër në Dibër;
- iii. vendim nr. *** prot., datë 14.3.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për regjistrimin e babait të subjektit për ushtrimin e profesionit të noterit;
- iv. certifikatë datë 7.2.1996, për dhënien e provimit të kualifikimit si noter të babait të subjektit;
- v. kërkesë datë 12.6.2006, e babait të subjektit për ndërprerje aktiviteti si noter drejtuar degës së tatim-taksave Peshkopi;
- vi. procesverbal për dorëzimin e vulave të noterit, mbajtur nga subjekti në cilësinë e përfaqësuesit të babait dhe specialistja e Ministrisë së Drejtësisë.
- vii. procesverbal datë 21.12.2006, për dorëzimin e arkivit të noterit mbajtur nga z. P M dhe Ministria e Drejtësisë.

Subjekti pretendon se të ardhurat e babait të tij si noter për periudhën 1.4.1996 – 15.6.2006 janë 18.375.000 lekë ose 150.000 lekë/muaj.

➤ **Në lidhje me aktivitetin si avokat për vitet 2006 - 2016**

- i. certifikatë regjistrimi datë 20.9.2007, në Zyrën e Tatim-Taksave Peshkopi për ushtrimin e profesioni avokat, me NIPT K***P;
- ii. certifikatë regjistrimi në QKR për “P .M”, person fizik, me NIPT K****D, datë regjistrimi 22.2.2008;
- iii. ekstrakt historik për shoqërinë “M.SH.C.” sh.p.k., datë regjistrimi 18.3.2014, ku z. P.M zotëron 60 % të koutave, objekti i shoqërisë aktivite juridike, pezulluar në datën 2.2.2016;
- iv. certifikatë regjistrimi në QKR për “P.M”, person fizik, me NIPT L****O, datë regjistrimi 1.2.2016.

Subjekti pretendon se të ardhurat e babait të tij si avokat për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2016 janë 11.560.000 lekë, viti 2007 – 600.000 lekë, vitet e tjera janë deklaruar.

71.2. Për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore të aktivitetit të babait të tij, subjekti ka depozituar:

- Vërtetim⁸⁰ për bazën e vlerësueshme të z. P (P) M për periudhën **1.1.1994 – 31.12.1997**, nga ku rezulton se janë paguara kontributet e mëposhtme:

Tabela nr. 16

⁸⁰ Depozituar në përgjigje të pyetësorit datë 1.6.2020

Viti	Paga mbi të cilin është derdhur kontributi/lekë
Janar - dhjetor 1994	2,560
Janar - dhjetor 1995	3,180
Janar - dhjetor 1996	4,100
Janar - dhjetor 1997	6,040
Janar - dhjetor 1998	6,040
Janar - mars 1999	6,040
Prill - dhjetor 1999	6,645
Janar - qershor 2000	6,645
Korrik - dhjetor 2000	7,773
Janar - qershor 2001	7,773
Korrik - dhjetor 2001	8,396
Janar - qershor 2002	8,396
Korrik - dhjetor 2002	9,403
Janar - qershor 2003	9,403
Korrik - dhjetor 2003	10,343
Janar - qershor 2004	10,343
Korrik - dhjetor 2004	11,376
Janar - shtator 2005	11,376

- Fletënjoftim tatimi datë **30.1.2000**, tatimi fiks 60.000 lekë për **xhiro deri në 2.000.000 lekë**
 - mandatarkëtim datë 21.1.2000, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 20.150 lekë tatim 6-mujori i parë i vitit 2000;
 - mandatarkëtim datë 30.6.2000, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 20.150 lekë tatim për vitin 2000;
 - mandatarkëtimi datë 25.9.2000, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 20.150 lekë tatim për vitin 2000.
- Fletënjoftim tatimi datë **28.2.2001**, tatimi fiks 60.000 lekë **për xhiro deri në 2.000.000 lekë**
 - mandatarkëtim datë 28.2.2001, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 30.150 lekë tatim, 6-mujori i parë i vitit 2001;
 - mandatarkëtim datë 27.3.2001, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 6.150 lekë taksë solidariteti;
 - mandatarkëtim datë 3.8.2001, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 30.150 lekë tatim, 6-mujori i dytë.
- Fletënjoftim tatimi datë **26.2.2002**, tatimi fiks 60.000 lekë për **xhiro deri në 2.000.000 lekë**
 - mandatarkëtim datë 8.2.2002, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 42.100 lekë (tatim + taksë solidariteti);
 - mandatarkëtim datë 4.7.2002, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 30.100 lekë tatim, 6-mujori i dytë.

- Vërtetim datë **4.2.2003**, nga ISSH, Dega Rajonale Dibër, ku vërtetohet se babai i subjektit ka paguar sigurimet shoqërore për vitin 2002
 - urdhërderdhje datë 19.3.2003, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 28.600 lekë, tatim i thjeshtë 15.000 lekë dhe taksë vendore 13.500 lekë;
 - urdhërderdhje datë 25.8.2003, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 30.100 lekë tatim i thjeshtuar, kësti i dytë;
 - tabelë e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin - qarkullimi i deklaruar 1.500.000 lekë.
- Urdhërderdhje datë **8.4.2004**, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 42.600 lekë, tatim i thjeshtë 27.500 lekë dhe taksë vendore 15.000 lekë
 - urdhërderdhje datë 30.9.2004, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 20.100 lekë;
 - urdhërderdhje datë 21.12.2004, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 7.600 lekë.
- Depozitim *cash* datë **31.8.2005**, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar: shuma nuk lexohet.
 - depozitim *cash* datë 20.10.2005, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 7.500 lekë, paguar tatim fitim kësti i tretë, viti 2005.
- Urdhërpagesë datë **18.3.2006**, shuma 24.245 lekë (tatim i thjeshtuar + taksë vendore)
 - depozitim *cash* datë 21.3.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 20.495 lekë tatim fitim i thjeshtuar, kësti i parë, viti 2006;
 - depozitim *cash* datë 21.3.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 626 lekë;
 - depozitim *cash* datë 21.3.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 3.750 lekë taksë vendore, kësti i parë;
 - urdhërpagesë datë 12.6.2006, shuma 9.375 lekë (tatim i thjeshtuar + taksë vendore);
 - depozitim *cash* datë 13.6.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 5.625 lekë tatim i thjeshtuar, kësti i dytë, viti 2006;
 - depozitim *cash* datë 13.6.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 375 lekë;
 - depozitim *cash* datë 13.6.2006, për Degën e Tatimeve Peshkopi, paguar shuma 3.750 lekë taksë vendore, kësti i dytë.

Me pyetësorin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- depozitim *cash* datë 21.3.2006, në BKT, nga z. P.M, me emërtim “derdhje për sigurime shoqërore, 3-mujori i parë në shumën 12.088 lekë”;
 - depozitim *cash* datë 21.3.2006, në BKT, nga z. P.M, me emërtim “derdhje për sigurime shoqërore, 3-mujori i parë i vitit 2006 në shumën 1.275 lekë”;
 - formular i deklaramentit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 3-mujori i dytë i vitit 2006, shuma e paguar 16.067 lekë.
- **Tabelë e llogaritjes së taksave, tarifave vendore dhe tatim i thjeshtuar i fitimit të biznesit të vogël ,viti 2008**
 - veprim arke datë 3.3.2008, taksë vendore, kësti i parë, viti 2008, shuma 19.000 lekë;
 - veprim arke datë 3.6.2008, taksë për Bashkinë, kësti i dytë dhe i tretë, viti 2008, shuma 15.000 lekë;
 - aktdetyrim i Bashkisë Peshkopi;
 - depozitë *cash* datë 5.12.2008, taksë biznesi i vogël, kësti i tretë dhe i katërt, viti 2008, shuma 22.500 lekë.

Me pyetësonin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- veprim arke datë 4.3.2008, “Raiffeisen Bank”, paguar sigurimet shëndetësore dhe shoqërore për periudhën shkurt - mars 2008, shuma 8.725 lekë;
- veprim arke datë 3.6.2008, “Raiffeisen Bank”, paguar sigurimet shëndetësore dhe shoqërore për 3-mujorin e dytë të vitit 2008, shuma 13.087 lekë;
- depozitim *cash* datë 12.9.2008, në BKT, nga z. P. M, me emërtim “derdhje për sigurime shoqërore në 3-mujorin e tretë në shumën 14.637 lekë.

➤ Vërtetim **datë 18.1.2010**, i Bashkisë Peshkopi, nëpërmjet së cilit vërtetohet se babai i subjektit për vitin 2009 ka paguar tatimet, taksat dhe tarifatat vendore për aktivitetin biznes i vogël avokat

- depozitë *cash* datë 4.2.2009, taksë biznesi i vogël në shumën 20.500 lekë;
- depozitë *cash* datë 6.7.2009, taksë biznesi i vogël në shumën 5.000 lekë.

Me pyetësonin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tremujori i parë i vitit 2009;
- formular deklarimi dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tremujori i dytë i vitit 2009, shuma e paguar 14.596 lekë;
- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tremujori i tretë i vitit 2009, shuma e paguar 14.508 lekë;
- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhjetor 2009, shuma e paguar 14.509 lekë.

➤ Njoftim vlerësimi tatimor nr. *****, **datë 3.4.2010**, Bashkia Tiranë

- depozitë në arkë datë 19.4.2010, 120 lekë taksë vendore table;e;
- depozitë në arkë datë 19.4.2010, 11.000 lekë taksa kombëtare;
- depozitë në arkë datë 19.4.2010, 3.483 lekë tarifë pastrimi;
- depozitë në arkë datë 20.4.2010, 6.333 lekë taksë vendore mbi biznes;
- depozitë në arkë datë 15.10.2010, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznes;
- depozitë në arkë datë 17.1.2011, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin.

Me pyetësonin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, periudha mars - shkurt 2010, shuma e paguar 9.672 lekë;
- depozitë në arkë datë 20.4.2010, në “Tirana Bank”, 9.672 lekë sigurime shoqërore, mars 2010;
- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2010, shuma e paguar 14.508 lekë;
- depozitë në arkë datë 8.7.2010, në “Tirana Bank”, 14.508 lekë sigurime shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2010;
- depozitë në arkë datë 8.7.2010, në “Tirana Bank”, 9.500 lekë sigurime shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2010;
- formular i deklaramit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, korrik 2010, shuma e paguar 14.508 lekë;
- depozitë në arkë datë 20.10.2010, në “Tirana Bank”, 14.508 lekë sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shtator 2010.

➤ Njoftim vlerësimi tatimor nr. *****, **datë 16.3.2011**, Bashkia Tiranë

- depozitë në arkë datë 18.10.2011, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 15.7.2011, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 13.1.2012, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;

- depozitë në arkë datë 18.4.2011, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 18.4.2011, 120 lekë taksë vendore tabela;
- depozitë në arkë datë 18.4.2011, 3.800 lekë tarifë pastrimi.

Me pyetësorin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mars 2011, shuma e paguar 15.138 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2011, shuma e paguar 15.138 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shtator 2011, shuma e paguar 15.786 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhjetor 2011, shuma e paguar 15.786 lekë.

➤ Faturë arkëtimi e Bashkisë Tiranë

- depozitë në arkë datë 18.4.2012, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 18.4.2012, 3.800 lekë tarifë pastrimi;
- depozitë në arkë datë 18.4.2012, 120 lekë taksë tabele;
- depozitë në arkë datë 13.7.2012, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 17.10.2012, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 17.1.2013, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin.

Me pyetësorin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mars 2012, shuma e paguar 15.786 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2012, shuma e paguar 15.786 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shtator 2012, shuma e paguar 16.667 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhjetor 2012, shuma e paguar 16.467 lekë.

➤ Njoftim detyrimi nr. **** prot., datë **27.3.2013**, i Bashkisë Tiranë

- faturë arkëtimi, Bashkia Tiranë;
- depozitë në arkë datë 15.4.2013, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 15.1.2014, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 15.7.2013, 9.500 lekë taksë vendore mbi biznesin;
- depozitë në arkë datë 15.4.2013, 120 lekë taksë tabele;
- depozitë në arkë datë 15.4.2013, 3.800 lekë taksë pastrimi.

Me pyetësorin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mars 2013, shuma e paguar 16.467 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, qershor 2013, shuma e paguar 16.467 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shtator 2013, shuma e paguar 16.905 lekë;
- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhjetor 2013, shuma e paguar 17.124 lekë.

➤ Faturë arkëtimi i Bashkisë Tiranë

- urdhërpagesë tatim-fitim i thjeshtuar, qershor 2014, shuma 6.250 lekë;
- depozitë në arkë datë 17.6.2014, 6.250 lekë tatim-fitim i thjeshtuar, qershor 2014;

- depozitë në arkë datë 17.6.2014, 200 lekë.

Me pyetësonin e datës 1.6.2020, ka depozituar edhe:

- formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mars 2014, shuma e paguar 11.340 lekë.
- Kërkesë për transaksion datë **18.12.2015**, në shumën 400.000 lekë
- Vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 21.10.2016, i ISSH-së, për z. P. M, për periudhën 1.10.2003 – 31.10.2016, vlera 1.644.352 lekë + *statement*-i i BKT-së për këtë shtetas ku kalon pensioni për muajt nëntor dhe dhjetor
- Vërtetim pensioni nr. **** prot., datë 20.10.2016, i ISSH-së për znj. M.M, për periudhën 1.2.1993 – 31.10.2016, vlera 2.144.924 lekë + *statement*-i i BKT-së për znj. M.M ku kalon pensioni për muajt nëntor dhe dhjetor

71.3. Nga hetimi ka rezultuar se:

- QKB-ja⁸¹ informon se z. P .M figuron i regjistruar si:
 - person fizik me NIPT L*****O, data e regjistrimit 1.2.2016;
 - person fizik me NIPT K*****D, data e regjistrimit 22.2.2008;
 - ortak me 60 % të koutave në shoqërinë “M.SH.C.” sh.p.k., me NIPT L*****O, regjistruar në datën 18.3.2014, aktualisht me status “pezulluar”.
- Bashkia Dibër⁸² informon se:
 - Subjekti P.M është i regjistruar si person fizik avokat, me vendim gjykate nr. ****, datë 3.9.1992, me NIPT K*****P. Nga periudha e regjistrimit 3.9.1992 deri më 30.12.2006 të gjitha detyrimet për taksat vendore dhe qarkullimin mbi xhiron deklaroheshin në DRT-në e rrethit Dibër dhe për këtë periudhë nuk disponohen të dhëna.
 - Për vitin 2007 subjekti ka deklaruar xhiro 1.500.000 lekë dhe ka paguar taksë dhe tarifa vendore në vlerën 11.500 lekë, ndërsa tatim në vlerën 30.000 lekë.
 - Në datën 22.2.2008 është regjistruar në QKB me NIPT K*****D dhe për këtë periudhë ka deklaruar një xhiro vjetore prej 1.500.000 lekësh dhe ka paguar tatim në vlerën 30.000 lekë, po ashtu ka paguar taksa dhe tarifat vendore në vlerën 11.500 lekë.
 - Në vitin 2009 xhiro e deklaruar është 1.500.000 lekë, tatimi 30.000 lekë, taksat dhe tarifat vendore 13.000 lekë.
- DRT-ja Dibër⁸³ informon se z. P.M në sistemin c@ts rezulton i regjistruar që më 3.9.1992, me NIPT K*****P, me objekt aktiviteti “aktivitete juridike”. Nga data 3.9.1992 ka kaluar në regjistrin me status “pasiv”. Në sistem nuk ka asnjë deklaratë, listëpagesë, detyrime tatimore apo pagesa të ndryshme të detyrimeve tatimore për këtë subjekt.
- ISSH, Drejtoria Rajonale Dibër, konfirmon faktin se z. P.M ka derdhur kontribute për periudhën 1994 – 2005 dhe vitin 2009, si vijon:

Tabela nr. 17

Viti	Paga mbi të cilën është derdhur kontributi
1994	2560
1995	3180

⁸¹ Shihni shkresën nr. ****prot., datë 13.12.2019

⁸² Shihni shkresën nr. **** prot., datë 26.5.2020

⁸³ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 22.8.2020

1996	4100
1997	4910
1998	6040
1999	6645
2000	7773
2001	8396
2002	9403
2003	10343
2004	11376
2005	12514
2009	16120

➤ DRT-ja Tiranë⁸⁴ informon se:

- P.M, i datëlindjes 4.8.1940, rezulton i regjistruar në datën 22.2.2008, me NIPT K****D, me objekt “aktivitete juridike” dhe me status “person fizik”. Nga verifikimet e kryera në dosjen e tij nuk disponohen të dhëna në lidhje me deklaratat e të ardhurave dhe qarkullimin e realizuar.

71.4. Mbështetur në të dhënat e sistemit tatimor të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të deklaruar janë paguar kontributet shëndetësore dhe shoqërore për periudhën dhjetor 2012 – shkurt 2014. Listëpagesat e periudhës para dhjetorit të vitit 2012 ndodhen në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Ky subjekt është person fizik dhe nuk shpërndan dividend, bazuar në nenin 5.6 të UMF-së, nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky subjekt ka detyrime të pashlyera në vlerën 302.763 lekë. Aktualisht rezulton me status “pasiv” nga data 26.8.2016.

71.5. Subjekti ka deklarata të padorëzuara, si vijon:

- për tatimin mbi vlerën e shtuar për periudhën prill 2014 – gusht 2016;
- për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014, 2015 dhe 2016;
- për tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2008 dhe 2012;
- për kontributet shoqërore për periudhën mars 2008 – dhjetor 2008, mars 2009 – shtator 2009, qershor 2014 - shtator 2014.

71.6. P.M është i regjistruar si person fizik me NIPT L****O, i regjistruar në sistemin tatimor më 1.2.2016, me aktivitet avokat. Të ardhurat e realizuara sipas deklaratave vjetore janë si vijon:

Tabela nr. 18

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Fitimi pas tatimit
2016	775,001	679,001	679,001
2017	1,208,334	1,016,334	1,016,334
2018	1,173,333	992,333	992,333
2019	0	0	0

⁸⁴ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 31.6.2020

71.7. Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nuk rezultojnë të jenë të paguara. Ky subjekt është person fizik dhe nuk shpërndan dividend bazuar në nenin 5.6 të UMF-së, nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

71.8. Në lidhje me shoqërinë “M.SH.C.”, me NIPT L****O, ajo është e regjistruar në datën 18.3.2014, me administrator D.C. Aktiviteti: aktivitete juridike

71.9. Të ardhurat e realizuara janë si vijon:

Tabela nr. 19

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Fitimi pas tatimit
2014	775,000	134,059	113,226
2015	1,034,973	575,953	550,953
2016	0	0	0

Kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend. Nga data 1.2.2016 ka statusin “pezulluar”.

➤ Bashkia Tiranë⁸⁵ konfirmon se:

- P.M është i regjistruar me NIPT K****D, me objekt “avokat”, me adresë: rr. “H. D”, pranë prokurorisë së rrethit, me status “aplikim për çregjistrim” datë 26.2.2014. Subjekti ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore deri më 26.2.2014. Xhiro e deklaruar: 0-2 milionë lekë/vit, për vitet 2010 - 2014.
- P .M është regjistruar me NIPT L****O, me aktivitet “avokat”, me adresë: rr. “M.B”, p. ***, me status “aktiv”, datë licencimi 1.2.2016. Subjekti ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 1.2.2016 – 31.12.2019. Xhiro e deklaruar 0-2 milionë lekë/vit, nga viti 2016 e në vazhdim.

➤ Të ardhurat e babait të subjektit nga pensioni i pleqërisë për periudhën 1.10.2003 – 31.5.2020⁸⁶ janë në total 2.727.681 lekë.

72. Komisioni ka konstatuar se në datat 18.12.2015 dhe 30.12.2015 shoqëria “M.SH.C.” sh.p.k. i ka depozituar babait të subjektit në llogarinë e tij në BKT shumën totale 800.000 lekë (400.000 lekë për secilin depozitim) me emërtim “pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie”. Komisioni administroi praktikën bankare⁸⁷ të këtyre dy transferimeve nëpërmjet së cilës konfirmohet fakti i emërtimit të pagesës, si dhe të dy kërkesat për transaksion rezultojnë të firmosura nga shtetasi D.C. Bazuar në deklaratën tatimore mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, shpenzimet e shoqërisë në vitin 2015 janë në shumën 459.020 lekë.

72.1. Në lidhje me këtë shumë subjekti ka sqaruar se: *“Në fund të vitit 2015 babai pati një përkeqësim të shëndetit dhe duke mos ditur rrjedhën që do të merrte sëmundja (në atë kohë 75 vjeç) kërkoi nga shoqëria që nga të ardhurat e saj t’i jepej në formë huaje shuma prej 800.000 lekësh që t’i përdorte për shpenzimet spitalore. Në këto rrethana, me vendim asambleje të ortakëve të datës 14.12.2015, u vendos t’i jepet babait një hua në shumën 800.000 lekë, me afat kthimi 10-vjeçar. Kjo gjë është pasqyruar edhe në kontratën e huas përpiluar mes z. D. C, me cilësinë e administratorit, dhe P.M, me cilësinë e huamarrësit/ortakut. Kontrata mban datën 16.12.2015. Po kështu kjo gjendje është pasqyruar edhe në bilancet (pasqyrat financiare)*

⁸⁵ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 29.5.2020

⁸⁶ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 8.6.2020, e ISSH, DR-ja Tiranë.

⁸⁷ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 29.12.2020

të shoqërisë dhe shuma është kaluar në dy transfertat bankare. Ai e ka pasqyruar si të ardhur, duke qenë se kështu iu deklarua nga ana e babait. Duke qenë se është marrëdhënie financiare mes dy ortakeve të shoqërisë, vlera prej 800.000 lekësh nuk i nënshtrohet tatimit”.

72.2. Subjekti ka bashkëlidhur:

- vendimin nr. ****, datë 14.12.2015, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregtare “M.SH.C.”, ku është vendosur dhënie e huas në shumën 800.000 lekë z. P.M;
- procesverbalin e mbledhjes së ortakëve të shoqërisë “M.SH.C.”, datë 14.12.2015, në të cilën deklarohet se z. P.M ka shprehur nevojën e një huadhënieje për arsye shëndetësore;
- kontratë huaje datë 16.12.2015, lidhur midis shoqërisë “M.SH.C.” dhe z. P.M;
- pasqyrat financiare të vitit 2015 të shoqërisë “M.SH.C.” në të cilin pasqyrohet dhënia e huas në shumën 800.000 lekë;
- deklaratë noteriale nr. ****, datë 17.12.2020, të z. D.C, i cili deklaron se *shuma 800.000 lekë, me vendim të asamblesë së ortakëve të datës 14.12.2015, u vendos t’i jepej hua ortakut P.M. Kjo gjendje është pasqyruar në bilancin e shoqërisë. Në formularët e derdhjes në bankë nga ana e ekonomistit është transkriptuar gabimisht shënimi “pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie.*

72.3. Deklarata e shtetasit D.C nuk do të merret në konsideratë, pasi në të ka të dhëna që nuk përputhen me hetimin: së pari, shuma 800.000 lekë nuk rezulton e deklaruar në pasqyrat financiare të depozituara në organet tatimore; dhe së dyti, transfertat janë bërë nga vetë shtetasi D.C dhe jo ekonomisti, siç deklaron ai.

72.4. Komisioni i kërkoi Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë pasqyrat financiare të shoqërisë “M.SH.C.” për periudhën e ushtrimit të aktivitetit të saj. Nga verifikimi i këtyre pasqyrave⁸⁸ të dorëzuara në DRT-në Tiranë nuk rezulton që të jetë pasqyruar dhënia e huas në shumën 800.000 lekë, sikundër pasqyrohet në pasqyrat financiare të depozituara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit.

72.5. Duke krahasuar këto dy dokumente rezulton se:

- i. Në pasqyrat financiare të vitit 2015 të shoqërisë “M.SH.C.” sh.p.k., të depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit datë 1.6.2020, te pasqyra “aktivet” në zërin “tituj të tjerë të huadhënies”⁸⁹ në kllapa është shënuar *hua financiare dhënë ortakut z. P.M,* ndërsa në kolonë e vlerës është vendosur shuma 800.000 lekë.
- ii. Në pasqyrat financiare të shoqërisë “M.SH.C.” sh.p.k. të vitit 2015, administruar nga DRT-ja Tiranë nuk rezulton një plotësim i tillë në zërin “tituj të tjerë të huadhënies”. Në asnjë vend të kësaj pasqyre financiare nuk rezulton të jetë deklaruar huaja e pretenduar dhënë z. P.M.

72.6. Në lidhje me shumën 800.000 lekë, rezulton se:

- babai i subjektit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” faktin që i ka hua shumën 800.000 lekë shoqërisë “M.SH.C.” sh.p.k. si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji nr. 84/2016;
- nga të dhënat e administruara nga organet tatimore shoqëria, në të dy vitet e marra së bashku, ka pasur një fitim që nuk mbulon shumën e huas në vlerën 800.000 lekë;
- në transfertat e kryera në BKT emërtimi nuk deklarohet si hua, por si pagesa për konsulencë;

⁸⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020

⁸⁹ Aktivet afatgjata/aktive financiare.

- në DVP/2015 subjekti ka deklaruar se shuma 800.000 lekë e ka burimin nga të ardhurat e babait të tij nga puna si avokat në shoqërinë “M.SH.C.” sh.p.k.;
- subjekti, në pyetësorin standard, por as në DVP/2015 dhe 2016 nuk ka deklaruar shpenzime mjekësore në shumën 800.000 lekë;
- në bilancet e shoqërisë “M.SH.C.” sh.p.k. të depozituar në DRT-në Tiranë, nuk rezulton të jetë deklaruar dhënia e huas në shumën 800.000 lekë.

72.7. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit: (i) deklaratimet e subjektit në lidhje me shumën 800.000 lekë nuk përputhen; (ii) babai i subjektit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, por as në DVP/2015 faktin që shuma 800.000 lekë i është marrë hua shoqërisë “M.SH.C.”; (iii) shoqëria “M.SH.C.”, bazuar në deklaratimet e saj në organet tatimore, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje; (iv) pasqyrat financiare të dorëzuara nga subjekti nuk përputhen me pasqyrat financiare të administruara nga DRT-ja Tiranë.

➤ Për rrjedhojë të sa më lart, shuma 800.000 lekë nuk do të përfshihet në analizë financiare.

72.8. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se *përshkrimi i vendosur në urdhër transfertë është transkriptuar gabim nga punonjësi i arkës së bankës, të cilin për thjeshtësi në deklaratë është përmendur si ekonomisti. Pasqyrat financiare të vitit 2015 të depozituar nga shoqëria “M.SH.C.” janë hartuar me gabime. Në datën 1.2.2016 shoqëria kaloi në status “pasiv” dhe nga administratori nuk ka qenë fokusimi aq i madh në përpilimin e saktë të pasqyrave financiare. Pasqyrat e para financiare janë depozituar nëpërmjet sistemit online në datën 27.3.2016. Shoqëria “M.SH.C.” ka depozituar pranë DRT-së Tiranë pasqyrat financiare të ndryshuara në datën 20.6.2020. Me shkresën nr. **** prot., datë 26.3.2021, DRT-ja Tiranë konfirmon pasqyrat financiare të depozituara në qershor të vitit 2020 dhe në deklaratën e tatim-fitimit, të ndryshuar. Në deklaratën “Vetting” konstatimi i Komisionit se nuk është deklaruar detyrimi ndaj shoqërisë është i drejtë. Ky mosdeklarim vjen për shkak të vështirësisë për të mbajtur mend dhe pasqyruar të gjitha detyrimet apo shpenzime që mund të kesh pasur ndër vite.*

72.9. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues që shuma 800.000 lekë i është dhënë hua nga shoqëria “M.SH.C.” sh.p.k. babait të tij. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe nga deklaratimet e babait të tij në DVP/2015, rezulton se kjo shumë është deklaruar si e ardhur. Subjekti nuk ka provuar gjatë hetimit, por as pas kalimit të barrës së provës, pagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, për rrjedhojë, nuk do të përfshihet në analizë financiare.

73. Në përfundim, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti tregtar për vitin 2000 e në vijim, pasi për periudhën 1993 – 2000 nga subjekti nuk u depozitua dokumentacion provues.

74. Të ardhurat e babait të subjektit janë përllogaritur si vijon:

I. Qarkullimi i konsideruar ose i përllogaritur nga aktiviteti tregtar:

- Për periudhat 2000 – 2002 dhe 2007 – 2014

Për të nxjerrë qarkullimin e biznesit të vogël, Komisioni është bazuar tek vlera e detyrimeve tatimore⁹⁰ të paguara dhe legjislacionit fiskal në fuqi.

⁹⁰ Me pyetësorin e datës 1.6.2020, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentet që provojnë pagesat e tatimeve dhe taksave të personit fizik “P.M”.: mandatpagesat e Bankës së Kursimeve për vitet 2000 - 2004; mandatpagesat e BKT-së dhe “R.B” për vitet 2005 – 2006 dhe 2008; mandatpagesat nga “T.B” për vitet 2010 - 2014. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka marrë përgjigje me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2020, nga Bashkia Dibër, për vitet 2007 - 2009; shkresë nr. **** prot., datë 29.5.2020, e Bashkisë Tiranë për vitet 2010 deri më 26.2.2014; shkresë nr. **** prot., datë 3.6.2020, e DRT-së Tiranë për vitet 2016 - 2018.

- Për periudhën 2003 – 2006

Qarkullimi është përlllogaritur në bazë të detyrimeve tatimore të paguara, duke u bazuar në legjislacionin fiskal në fuqi ku masa e tatimit është 4 % për xhiron 0 – 2 milionë lekë.

- Të ardhurat për vitet 2016 e në vijim janë bazuar në shkresën nr. **** prot., datë 3.6.2020, të DRT-së Tiranë.

II. Është konsideruar një marzh fitimi në masën 80 %, bazuar në: (i) shpenzimet e supozuara të personit fizik “P.M”⁹¹; dhe (ii) në praktikën e aplikuar nga Komisioni në rastet e ngjashme⁹².

III. Nuk është përfshirë si e ardhur fitimi për periudhën 1993 – 1999, kur babai i subjektit ka ushtruar aktivitet, si:

- a. Avokat në Peshkopi gjatë viteve 1993 deri më 12.2.1996

74.1. DRT-ja Dibër⁹³ informon se subjekti P.M ka qenë i regjistruar pranë këtij organi në datën 3.9.1992 dhe po në të njëjtën datë ka kaluar në regjistër me status “pasiv”. Gjithashtu, megjithëse deklaroi se ka paguar rregullisht detyrimet⁹⁴, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion pagesat e tatimeve për periudhën, por vetëm pagesat ndaj sigurimeve shoqërore.

- b. Noter në Peshkopi për periudhën 13.2.1996 – 31.12.1999

74.2. Megjithëse në procesverbalin⁹⁵ për dorëzimin e arkivit të noterit, mbajtur në datën 21.12.2006 në Peshkopi, rezultoi se gjatë kësaj periudhe ka pasur veprime noteriale, subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë dokument provues/kopje të regjistrimit noterial⁹⁶ mbi xhiron apo detyrime tatimore të paguara për këtë periudhë.

IV. Për periudhën 1994 – 1999, për të ardhurat e babait është konsideruar paga sipas sigurimeve shoqërore⁹⁷

74.3. Komisioni, pasi analizoi të ardhurat e babait të subjektit si më lart, i kaloi subjektit barrën e provës për mungesë burimesh të ligjshme kumulative për periudhën 1993 deri më 31.7.2008 (para emërimit në detyrë), në shumën 5.436.737 lekë.

74.4. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi në lidhje me të ardhurat e babait, duke depozituar dokumentacion provues, trajtuar më në detaje në pikat 27.2.2.5 dhe 27.2.2.6 të këtij vendimi. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe pranoi të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e babait për periudhën 1993 – 2000, ka rikryer analizën financiare për periudhën 1993 – 31.7.2008, duke rezultuar me një bilanc negativ kumulativ në vlerën 2.531.189 lekë.

74.5. Në konkluzion, në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit, si dhe me pasuritë e krijuara prej tij gjatë periudhës 1993 – 2008, periudhë përpara se subjekti të kishte filluar detyrën e prokurorit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin

⁹¹ Pagesat e qirasë, detyrimeve ndaj shtetit dhe ato operacionale.

⁹² Vendimet nr. 175, datë 4.7.2019 (V. S); nr. 254, datë 4.6.2020 (E.Sh), nr. 119, datë 11.10.2019 (T), nr. 197, datë 27.9.2019 (H), të Komisionit.

⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, e DRT-së Dibër.

⁹⁴ Pyetësori i datës 1.6.2020, përgjigje pyetjes nr. 5/a.

⁹⁵ Vënë në dispozicion nga subjekti me pyetësorin e datës 1.6.2020, në përgjigje të pyetjes nr. 5.

⁹⁶ Pyetësori i datës 1.6.2020, në përgjigje pyetjes nr. 5/b, subjekti deklaroi: “... duke iu referuar regjistrave noterialë kam deklaruar se në këtë periudhë 1.4.1996 deri më 15.6.2006 kam realizuar të ardhura 18.375.000 lekë”.

⁹⁷ Subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin e ISSH-së për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me pyetësorin e datës 1.6.2020, në përgjigje të pyetjes nr. 5.

të ardhura të mjaftueshme për krijimin e këtyre pasurive, si dhe nga ana e tij dhe personit të lidhur (babait të tij) nuk janë deklaruar saktë të ardhurat e krijuara për periudhën 1993 – 2000.

74.6. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me të ardhurat e krijuar nga babai i tij, si dhe nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e pasurive për periudhën 1993 – 2008, në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

75. Në lidhje me të ardhurat e prindërve, subjekti ka deklaruar në DVP/2003 se ata disponojnë **2.500.000 lekë në Bankën e Kursimeve.**

75.1. Në lidhje me këtë shumë, subjekti, në procesverbalin e datës 23.3.2016, në ILDKPKI⁹⁸, ka deklaruar se kjo depozitë është krijuar në vitin 2003, me burim “të ardhurat familjare të prindërve dhe të tijat ndër vite”, me qëllim për të blerë apartamentin me sip. 152 m². Kjo vlerë i ka kaluar në datën 1.12.2004 shoqërisë “N” sh.p.k., si kështu i parë për blerjen e apartamentit. Si burim për këtë depozitë subjekti, në të njëjtin procesverbal, ka deklaruar shumën 1.500.000 të përfituar nga shitja e lokalit në qytetin e Dibrës.

75.2. Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion depozitën e prindërve në Bankën e Kursimeve në shumën 2.500.000 lekë.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat.

DEKLARIMI I NËNËS SË SUBJEKTIT, ZNJ. M. M – DEKLARIMI I PASURIVE

76. Llogari bankare me nr. IBAN AL***L, në BKT⁹⁹, ku derdhet pensioni. Shuma aktuale deri në datën 24.1.2017 është 283.056 lekë.**

Hetimi¹⁰⁰/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

77. Nga nxjerrja e llogarisë së nënës së subjektit në BKT gjendja e llogarisë në datën 20.1.2017 është 283.056,45 lekë. Kjo llogari është hapur më 28.5.2013, me një depozitim *cash* në shumën 100.000 lekë.

77.1. Të ardhurat e nënës së subjektit nga pensioni i pleqërisë për periudhën 1.2.1993 – 31.5.2020¹⁰¹ janë në total 3.061.853 lekë.

Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë deklaram.

77.2. Nga hetimi ka rezultuar se në kontratën e sipërmarrjes nr. ***

, datë 16.5.2014, është deklaruar se babai i subjekti ka përfituar **tokë truall me sip. 750 m²** nga trashëgimtarët e A. K, I.K dhe H.L. Sipas kësaj kontrate deklarohet se ky truall rezulton të jetë regjistruar në emër të babait të subjektit dhe z. R.I. Kjo pasuri nuk rezulton të jetë deklaruar nga babai i subjektit në deklaratën “Vetting”.

77.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se kontrata e sipërmarrjes (paraprake) ndërmjet pronarëve të truallit dhe sipërmarrësit (investitorit) është nënshkruar me qëllim që palët të angazhoheshin se në rast të pajisjes me certifikatë pronësie, pronarët pranonin se të drejtën e vetme për të bërë ndërtimin e ka vetëm shoqëria “M” sh.p.k. Nga ana tjetër, shoqëria

⁹⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.6.2020, të ILDKPKI-së.

⁹⁹ Subjekti ka depozituar dokumentin nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, të BKT-së për znj. M.M

¹⁰⁰ Shkresë nr. **** prot., datë 4.12.2019, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.5.2020, e BKT-së.

¹⁰¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2020, të ISSH-së, DR-ja Tiranë.

do të angazhohej dhe do të merrte përsipër bashkë me avokatët (babain e subjektit) që do të analizonin dosjen, të regjistrohej vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave. Shoqëria, gjithashtu, do të interesohej për PDV-në e zonës dhe pajisjen me leje ndërtimi. Kontrata quhej paraprake sepse në momentin që trualli do të regjistrohej në emër të pronarëve do të hartoheshin kontrata të veçanta të pronarëve të truallit me sipërmarrësin. Kjo kontratë, nëse nuk do të përmbusheshin detyrimet dhe të bëhej e mundur realizimi i qëllimit të objektit të kontratës, nuk kishte asnjë efekt ligjor. Vetë deklarata noteriale (prishje kontrate sipërmarrjeje) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2018, tregon se nga ana e shoqërisë nuk u përmbushën detyrimet e parashikuara në kontratë dhe arritja e pajisjes me certifikatë pronësie të pronarëve të truallit. Në janar të vitit 2017, pas 2 vjet e gjysmë nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes paraprake, palët ishin në vetëdije të plotë të mosrealizimit të saj. Subjekti ka pretenduar se nuk mund të përgjigjet sot për arsyen e mosdeklarimit të kësaj nga babai i tij, por mendon se kontrata me kusht¹⁰² nuk prodhoi asnjëherë një të drejtë reale për pjesën takuese që do të merrnin në rast të pajisjes me certifikatë pronësie. Babai i tij nuk kishte të regjistruar ndonjë pasuri apo të kishte një të drejtë reale mbi këtë truall. Marrëdhënia juridiko civile do të lindte vetëm nëse plotësohej kushti.

77.4. Subjekti ka depozituar: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ****, datë 16.5.2014; dhe (ii) deklaratë noteriale (prishje kontrate sipërmarrjeje) nr. ****, datë 10.10.2018, nëpërmjet së cilës është prishur kontrata e sipërmarrjes e mësipërme.

77.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, duhet të deklaronte të drejtat që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes, pasi në të parashikohej krijimi i të drejtave të pronësisë në të ardhmen, duke e vënë babain e subjektit (person i lidhur) në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

77.6. Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, i ka kaluar subjektit barrën e provës se pamundësia totale e subjektit dhe familjarëve të tij për të krijuar pasuritë dhe kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara, është në vlerën 9.361.522 lekë (shuma e viteve me rezultat negativ).

77.7. Në analizë janë marrë në konsideratë:

- të ardhura nga paga e subjektit, konsideruar pagat si asistent zyre në OSCE, OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, OPGJ në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Kurbin, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, të ardhurat si pedagog i jashtëm në universitetin “E”, të ardhura nga puna në Fondacioni SEMA/universiteti “B”;
- të ardhura nga paga e bashkëshortes si punonjëse administrate në universitetin “E” dhe punonjëse në Fondacionin H, A.K;
- të ardhurat nga aktivitetet private të babait, metodologjia e përdorur si më sipër;
- të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor i babait të subjektit;
- pensioni i nënës referuar vërtetimit nr. ***, datë 8.6.2020, të ISSH-së Tiranë;
- pensioni i babait referuar vërtetimit nr. ***, datë 11.11.2011, të ISSH-së, sjellë nga subjekti;
- shpërblime për lindjen e fëmijëve (nga Bashkia);
- të ardhura nga interesat bankare;

¹⁰² Shihni vendimin nr. 37, datë 24.1.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera citohet: “Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e gjen me vend të nënvizojë dhe të sjellë në vëmendje të gjykatave të faktit se pasojat juridike të vërtetimit ose jo të kushtit, në veprimet juridike që e kanë pjesë atë (kushtin), vijnë vetiu (ipso jure) pa qenë nevoja që palët të bëjnë ndonjë veprim. Në rastin e mos vërtetimit të kushtit pezullues, veprimi juridik nuk fiton fuqi juridike, ai konsiderohet sikur nuk është kryer”.

- të ardhura nga shitja e pasurive;
- likuiditete të mbartura nga para detyrës;
- në analizë nuk janë konsideruar si burim i ligjshëm të ardhurat e bashkëshortes deklaruar dhuratë nga prindërit e saj, pasi nga subjekti nuk është bërë e mundur dokumentimi i tyre.

77.8. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se:

- Gjendja *cash* e babait në fund të vitit 2008 ka qenë shuma e tërhequr në nëntor të vitit 2008, në shumat 1.009.076 lekë dhe 45.000 euro, të kthyer nga motrat. Kursi i këmbimit për shumën 45.000 euro mbetet i pandryshuar përgjatë viteve në vijim.
- Në vitin 2009 duhet të përfshihet në analizë kthimi i huas nga shtetasi V. M dhe të njihen si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga shitja e automjetit.
- Duhet të merret në konsideratë mundësia për kursim e babait në fund të çdo viti, bazuar në transaksionet që ky i fundit ka kryer në këtë periudhë dhe mundësinë e kursimit që kanë pasur çdo vit.
- Në vitin 2015 duhet të përfshihet në analizë huaja e marrë nga shoqëria “M.SH.C.” sh.p.k. në shumën 800.000 lekë.

77.9. Në lidhje me pretendimet e mësipërme të subjektit, ato janë trajtuar në detaje në këtë vendim, ku Komisioni ka vendosur të mos i marrë në konsideratë.

78. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe familjarët e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 9.361.522 lekë për krijimin e pasurive për vitin 2008 e në vijim, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

79. Komisioni shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti për pyetësorët e dërguar, si dhe provat e parashtrimet në përgjigje të barrës së provës.

79.1. Në përfundim konstatohet se:

- i. subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen pasurisë apartament me sip. 133.4 m², ndodhur në rrugën “D. B”, Njësia nr. **, Tiranë, në pronësi të babait të tij, si dhe nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie;
- ii. subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për depozitimin e shumës 2.700.000 lekë nga ana e babait në fillim të vitit 2017;
- iii. subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e llogarisë së kursimit dyemërore të tij dhe nënës në BKT;
- iv. subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për gjendjen *cash* si trung familjar në shumën 1.400.000 lekë;
- v. subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huave shtetasve Sh. Ll. dhe Xh. K, në shumën totale 6.000.000 lekë;
- vi. subjekti dhe babai i tij nuk kanë deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë lokal me sip. 80 m²;
- vii. subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për krijimin e pasurive për periudhën 1993 – 2008;

- viii. subjekti dhe babai i tij, në cilësinë e personit të lidhur, nuk kanë deklaruar saktë të ardhurat e krijuara për periudhën 1993 – 2000;
- ix. babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të drejtat që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes nr. ****, datë 16.5.2014;
- x. subjekti dhe familjarët e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 9.361.522 lekë për krijimin e pasurive për vitin 2008 e në vijim;
- xi. subjekti nuk ka pasqyruar saktë në deklaratën “Vetting” mënyrën e fitimit të pasurisë automjet tip “M-B *** D”, pasi rezultoi se i është dhuruar dhe jo blerë prej tij;
- xii. subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip “M-B *** D”;
- xiii. subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip “V.Sh”;
- xiv. subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë garazh në pronësi të babait të tij;
- xv. subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë bankare në emër të tij dhe bashkëshortes së tij në BKT.

79.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se:

- i. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të gërme “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të gërme “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
- iii. subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm: (i) të të ardhurave të babait të tij; si dhe (ii) pasurive të krijuar nga babai i tij ndër vite, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

80. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. **** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.6.2020, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

80.1. Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Maksuti.

80.2. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit

të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

81. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin¹⁰³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

Raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe analiza e Komisionit

81.1. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

81.2. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

81.3. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale dhe; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

81.4. Gjetjet në lidhje me pesë dosjet penale të përzgjedhura me short

81.4.1. Komisioni, nga pesë dosjet e analizuara, i kërkoi shpjegime subjektit vetëm për dosjen 1, si vijon:

81.4.2. Kallëzimi penal nr. ***/2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë vendimi 25.3.2016.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është bazuar në nenin 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale. Nga konfirmimi zyrtar nr. *****, datë 13.12.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar.

Dokumenti ligjor “vendim mosfillimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese, fillimisht përshkruhet fakti penal i referuar dhe mënyra e njoftimit, konkretisht nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, Tiranë. Më tej përshkruhen të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit. Në fund

¹⁰³ Raporti nr. *** prot., datë 24.2.2020

analizohet mungesa e elementeve të veprës penale, pasi është arritur në konkluzion se fakti konsiderohet si kundërvajtje administrative që rregullohet në rrugë ligjore administrative. Në pjesën e dispozitivit prokurori përshkruan vendimmarrjen e tij.

81.4.2. Komisioni, pasi ka analizuar dosjen e procedimit penal konstaton se:

- i. ndryshe nga sa deklarohet në vendimin e mosfillimit, znj. K.A i është refuzuar kërkesa për pajisje me leje mjedisi, tip C, në datën 30.12.2015, me motivacionin, ndër të tjera, se ka ankesë nga banorët e zonës;
- ii. subjekti nuk ka thirrur për të dëshmuar asnjë nga banorët e pallatit në lidhje me denoncimin e tyre;
- iii. subjekti nuk ka verifikuar nëse bombolat e gazit plotësonin kushtet teknike apo ishin të pozicionuara sipas kushteve teknike;
- iv. subjekti nuk ka verifikuar se kujt i përkiste ambienti ku ishin vendosur bombolat dhe depozita e uji;
- v. subjekti nuk ka verifikuar nëse ishte marrë leje për të shfrytëzuar ambientet e përbashkëta të pallatit për të vendosur tubin e aspirimit;
- vi. subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me ankesën e banorëve për bar-kafe restorant “T.B”;
- vii. subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të verifikuar nëse janë bërë ankesa të tjera dhe çfarë ka ndodhur me to, pasi banorët ngrenë pretendimin se personat e strukturave ku kanë bërë denoncimin kanë ardhur dhe pas kontakteve me pronarët e këtyre bizneseve janë larguar, duke ngritur pretendimet për mitëmarrje;
- viii. nga aktet e dosjes nuk rezulton që vendimi i mosfillimit t’i jetë njoftuar denoncuesve, detyrimi i parashikuar nga nenin 291 i Kodit të Procedurës Penale.

81.4.3. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

81.4.4. Subjekti, në lidhje me këto konstatime, pretendoi se: *“Duke iu referuar materialeve të administruara në fashikullin e këtij kallëzimi, në faqen nr. 30 është administruar shkresa nr. *** prot., datë 10.2.2016, dhe në faqen nr. 2 të saj (faqe nr. 31 të fashikullit) theksohet se kërkesa e subjektit K.A për t’u pajisur me leje mjedisi, tipi C, nuk është marrë ende në shqyrtim nga Agjencia Rajonale e Mjedisit të Qarkut Tiranë. Po kështu, në këtë shkresë është vendosur edhe afati brenda të cilit do t’i kthehej përgjigje subjektit. Në këto kushte konstatohet se kjo agjenci ishte ende në proces vlerësimi të subjektit në fjalë nëse i plotësonte kushtet për t’u pajisur me leje të tipit C. Në lidhje me këtë pikë theksojmë se ankesa e banorëve ishte e qartë dhe nuk u konsiderua i nevojshëm administrimi i deklarimeve të tyre, pasi rrethanat e kallëzimit ishin evidente. Nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes (faqe 14-16 të fashikullit) nuk është konstatuar nga policia gjyqësore nëse depozita e gazit të lëngshëm ishte jashtë kushteve të sigurisë. Duhet theksuar se edhe ankesa në tërësi e banorëve të pallatit ishte e karakterit administrativ [...]. Bazuar në parashikimet ligjore është Agjencia Kombëtare e Mjedisit autoriteti kryesor për marrjen e masave të tilla dhe nga ana e tyre kësaj agjencie i është kërkuar informacion për rastin në fjalë, nga ku me shkresën nr. **** prot., datë 10.2.2016, dhe në faqen nr. 2 të saj (faqe nr. 31 të fashikullit) u informuan se kjo kërkesë ishte në shqyrtim. Agjencia Rajonale e Mjedisit ka theksuar se afati ligjor për marrjen e vendimit do të ishte data 24.2.2016. Janë kryer verifikimet nga policia gjyqësore dhe pas thirrjes dhe pyetjes së subjektit K. A në prokurori, si dhe kërkimit e marrjes së informacionit nga organet kompetente, u stabilizua situata dhe u morën masat përkatëse. Nuk ka pasur më ankesë nga banorët e pallatit në lidhje me problematikën e paraqitur më parë prej tyre. Problematika e konstatuar ishte*

tërësisht administrative dhe masat e marra janë po administrative. Bazuar në Kodin Penal, rrethanat e kallëzuar nuk përbënin konsumim të asnjë prej veprave penale të parashikuara në këtë kod, por vetëm kundërvajtje administrative të cilat ishin në proces verifikimi, pasi e kallëzuar/aplikantja ishte ende në pritje të përgjigjes [...]. Duhet theksuar fakti se nuk kishte indicie apo të dhëna për mitmarrje. Duke qenë se banorët që kishin bërë ankesën ishin 18 vetë, u ngarkua verbalisht policia gjyqësore që t'ua njoftonte vendimin banorëve”.

81.4.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nga ana e tij nuk i janë dhënë përgjigje të gjitha konstatimeve të Komisionit. Subjekti nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me konstatimet për pikat 3 – 7. Subjekti nuk provoi që vendimi i mosfillimit t'i jetë njoftuar denoncuesve, sipas parashikimeve të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti pretendon se kemi të bëjmë me një çështje administrative dhe jo penale, por nga veprimet hetimore të kryera nga ana e tij nuk del qartë ky fakt. Nga dokumentacioni në fashikullin penal rezulton se znj. K.A i ishte refuzuar një herë aplikimi për leje mjedisore, me motivacionin, ndër të tjera, se ka ankesë nga banorët e zonës. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me pretendimet e banorëve për mitmarrje, si dhe për ankesën e banorëve për bar-kafe restorant “T. B”, gjithashtu ai nuk ka kryer veprime të tjera hetimore të sipërcituara. Vetëm pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore mund të arrihej në konkluzion që kishim të bënim me një çështje të thjesht administrative apo penale.

82. ANALIZA E GJETJEVE¹⁰⁴

1. Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Vetëm në një rast nga ana e subjektit nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore.

b. Arsyetimi ligjor

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Duke iu referuar vërtetimit nr. ***, datë 19.11.2019, dhe listës së statistikave, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 22.11.2019, konstatohet se janë 1075 (një mijë e shtatëdhjetë e pesë) çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit të marra në shqyrtim për shortim. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se subjekti është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të

¹⁰⁴ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

përzgjedhura me short, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Duke evidentuar vendimmarrjen e mosfillimit të procedimit penal që duhej të kryhej në një periudhë më të shpejtë, në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Ai ka realizuar mbledhjen në kohë të provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara edhe në vlerësimet e bëra ndaj tij nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “shumë mirë”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë rezulton se subjekti ka përmbushur me korrektësi kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti rezulton të jetë angazhuar në disa aktivitete profesionale të organizuara.

Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaroi se ka marrë pjesë në disa trajnime brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës, duke shprehur gatishmërinë e tij për t'u rritur nga ana profesionale.

83. DENONCIMET

83.1. Në Komision janë paraqitur tri denoncime, por subjektit i janë kërkuar shpjegime vetëm për denoncimin e bërë nga shtetasi Sh.H¹⁰⁵.

83.1.1. Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin. Komisioni, pasi analizoi vendimin datë 2.10.2013, të subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013, konstaton se nga ana e subjektit është konkluduar se kemi të bëjmë me falsifikim dokumentesh, por duke qenë se kanë kaluar mbi 10 vjet vepra penale është parashkuar. Ndërkohë, nga ana e tij nuk është argumentuar fakti se përse përjashtohen nga procedimi penal shtetasit A. H dhe H.H, të cilët kanë përdorur dokumente që sipas subjektit rezultojnë të falsifikuara. Bazuar në nenin 186 të Kodit Penal, përdorimi i dokumenteve të falsifikuara konsiderohet vepër penale.

83.1.2. Subjektit iu kërkuar shpjegime, pasi nuk ka argumentuar vendimin e pushimit në lidhje me faktin se përse nuk është kryer vepër penale nga shtetasit H dhe A.H, për sa kohë rezulton se kanë përdorur dokumente të falsifikuara, duke përfituar pasuri dhe të ardhura prej tyre.

83.1.3. Subjekti, në lidhje me këtë rezultat, sqaroi se: *“Nga këqyrja dhe verifikimi i dokumenteve të ndodhura në ZVRPP rezulton se: Komuna Kashar ka dërguar pranë kësaj zyre aktet e marrjes së tokës në pronësi për Komunën Kashar, ndërmjet të tjerave aktet: 1. nr. nuk ka, datë 2.8.1995, për z. Sh. H, gjithsej 13.000 m²; 2. nr. nuk ka, datë 2.8.1995, për z. A. H, gjithsej 11.000 m²; 3. nr. nuk ka, datë 2.8.1995, për z. H. H, gjithsej 12.800 m²; 4. nr. **, datë 19.10.1995, për z. A.H, 12.500 m²; 5. nr. **, datë 2.8.1995, për z. H. H, 24.000 m². Pas këqyrjes së bërë në këtë zyrë rezulton se të gjitha të dhënat janë hedhur në sistemin digjital nga projekti që ka punuar në ZVRRP-në Tiranë. Pas printimeve të para në numra pasurish të ndryshëm është ndërhyrë duke prishur me bojë të njomë disa emra dhe shënuar me shkrim dore emra pronarësh të tjerë. Projekti ka përfunduar në datën 1.7.1998. Duke hapur kartelën e pasurisë me numrin përkatës, emrin e pronarit, llojin e tokës, sipërfaqen përkatëse. Nga këqyrja e dokumenteve rezulton se: pas printimeve të para është ndërhyrë në emrin e Sh.H e të tjerëve duke u vendosur emrat e H.H dhe A.H. Kështu, në një rast pasuria nr. ***, volumi **, faqe **, në fillim ka qenë Sh.H për 4.000 m² arë, është fshirë emri i tij dhe shënuar H. H. Në pasurinë nr. ***, volumi *, faqe *, ka qenë Sh.H arë 5.000 m², është fshirë duke u shënuar emri A. H. Duke analizuar të dhënat e sipërpërmendura, arrihet në konkluzionin se persona të ngarkuar me detyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme kanë ndërhyrë në dokumente zyrtare me anë të falsifikimit të të dhënave (duke ndryshuar emrin e pronarëve), pikërisht ato të dërguara nga Komuna Kashar. Këto veprime janë të kundërligjshme, pasi kanë prekur marrëdhëniet juridike për të mbrojtur veprimtarinë e rregullt të institucionit shtetëror me anë të ndryshimit të të dhënave. Ato parashikohen si vepër penale ‘falsifikim i dokumenteve’, parashikuar nga*

¹⁰⁵ Denoncimi nr. ***, datë 18.7.2018

neni 186 i Kodit Penal. Njëkohësisht me këto veprime personi i ngarkuar me një detyrë shtetërore me veprimet e tij kriminale ka cenuar interesat e ligjshme të shtetasve, të cilat parashikohen vepër penale 'shpërdorim detyre', parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Provohet se këto veprime janë kryer nga punonjës të projektit të kontraktuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, përfunduar në datën 1.7.1998. Të dy veprat penale rezultojnë se janë kryer para 10 vjetëve, të cilat në bazë të nenit 66, germa 'b' e Kodit Penal janë parashkruar. Në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal janë hetuar me hollësi të dy shtetasit H dhe A. H, veprimtaria e tyre dhe dokumentacioni i përdorur prej tyre. Nga hetimi ka rezultuar se këta shtetas nuk kanë qenë ata që kanë kryer falsifikimin e dokumenteve, por sikurse është argumentuar më lart, këto veprime janë kryer nga punonjës të projektit të kontraktuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, përfunduar në datën 1.7.1998. Të dy veprat penale rezultojnë se janë kryer para 10 vjetëve, të cilat në bazë të nenit 66, germa 'b' e Kodit Penal janë parashkruar. Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara së pari lidhet me anën subjektive të personit që posedon dokumentin, nëse ka dijeni që ky dokument është i falsifikuar apo jo. Provueshmëria e anës subjektive në këtë rast nuk është arritur, pasi palët kanë qenë dhe në konflikte civile me njëri-tjetrin dhe secili pretendon në të drejtën e tij. Gjithsesi, edhe duke marrë apriori që shtetasit H dhe A. H kanë qenë në dijeni të faktit se dokumentet e konstatuara të falsifikuara, në vendimin e pushimit është shprehur se afati i përdorimit të këtyre dokumenteve është më shumë se 5 vjet, çka bën që vepra penale 'falsifikim i dokumenteve', nëpërmjet përdorimit, neni 186/1/2 i Kodit Penal, të mos ndiqet penalisht për shkak të afatit të parashkrimit i cili, bazuar në sanksionin e veprës 'falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim **deri në tre vjet**. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga **gjashtë muaj deri në katër vjet**', përsëri është i parashkruar, pasi nga momenti i fundit i përdorimit të këtyre dokumenteve nga ana e shtetasve H dhe A.H, deri në regjistrimin e procedimit penal, kanë kaluar mbi 5 vjet, sikurse parashikohet edhe nga neni 66/c i Kodit Penal [...]. Ndaj vendimit të pushimit është bërë ankim nga ana e tij, pasi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. **/akti, datë 8.4.2014, është vendosur; pranimin e kërkesës së ankimesit A dhe H. H dhe ndryshimin e vendimit të prokurorisë të datës 2.10.2013, duke pushuar çështjen penale jo më bazuar në nenin 328, pika 'd', për shkak se vepra penale është parashkruar, por duke e ndryshuar atë në vendim pushimi bazuar në nenin 328, pika 'b', pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”.

83.1.4. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë denoncim janë bindëse.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

84. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

84.1. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

84.2. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në përgjigje të barrës së provës, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar në pikën 2 të nenit 4, germën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.4.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha